

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Eri MURATI
Zv/kryeredaktorë - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIII - Nr. 7598 E hënë 23 Korrik 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Dje në 'Deutsche Welle'
Në takim e ministrave të Financave të vendeve të G-20-ës në Argentinë u arrit që në deklaratën e përbashkët të theksohej se rritja e tensioneve tregtare...
Vijon në faqen 20

G20 - Argentinë:
Thirrje për ruajtjen e dialogut


Opinion i Ditës
Nga FATOS ÇOÇOLI
Ka afro katër vjet që çmimi i energjisë elektrike tek ne nuk ndryshon. Ndryshimi i fundit, me rritje të çmimit edhe për familjarët, ndodhi në 30 dhjetor 2014...
Vijon në faqen 21

Duhet ulur çmimi i energjisë elektrike?



Ministri i Jashtëm gjerman, takime edhe me opozitën

Michael Roth: Kampet e refugjatëve nuk janë kusht, politika të mos rrezikojë negociatat

Ditmir Bushati: Ka strategji të orkestruar, që mban peng raportet me Greqinë

Nga DARINA TANUSHI


Ministri i Jashtëm gjerman, Michael Roth i bëri thirrje dje nga Tirana klasës politike shqiptare që të marrë përgjegjësitë dhe të mos pengojë procesin integrues të Shqipërisë. Pas një takimi me ministrin...

Në faqen 3

LISTA E PARE/ EMRAT E PERFITUESVE QE DOREZUAN DOSJET E VITEVE 1997-1998

KOMPENSIMI I PRONAVE, 3260 PRONARET QE MARRIN PARATE

Agjencia e Trajtimit të Pronave: Ja formulari që duhet të plotësoni për të marrë vlerën e paracaktuar dhe dokumentet që duhen bashkëngjitur



(Në foto) Foto ilustruese

PD-LSI: RIKTHIM 'TEATRIT'

Sot mbyllet Kuvendi, ja ligjet që duan 84 vota dhe që do të shtyhen për në shtator

Në faqen 2

FLASIN DESHMITARET

Vidhnin me armë bashkë me kushërinin karburantet, kush është Anna Malaj, grabitësja "sexy"

Në faqen 7

DIPLOMATJA, NGA THETHI

Vlahutin: Kemi punuar fort në luftën kundër kanabisit, por njëzetit duan mundësi zhvillimi

Në faqen 12

DOSSIER

Polovina: Marrëveshja e Mukjes ishte një lojë, PKSH dhe BK s'kanë dashur kurrë të bashkëpunojnë

Në faqen 19

KESHILLAT E NJEKUT POPULLOR YLLI MERJA



Nefrologu Gjirkondi: 4 në 5 femra preken nga infeksioni urinar, si të ruheni e mjekoheni
Suplement

Dokumentet që duhet të plotësojë mosha e tretë për të përfituar 648 lekë në muaj

Kompensimi i energjisë, aplikimi për pensionistët

ISSH: Si duhet të veprojnë personat që marrin pension rishtas

Nga ORNELA MANJANI

Pensionistët që duan të përfitojnë kompensimin për energjinë elektrike, i caktuar në masën 648 lekë në muaj duhet të plotësojnë pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore formularin-tip. Kompensimi i energjisë ele-



trike për efekt të heqjes së fashës mbrojtëse prej 300 kwh në muaj përfitohet nga familjet me ndihmë ekonomike, kryefamiljarët në pensione pleqërie e invaliditeti, familjet që kanë në përbërje persona me aftësi të kufizuara, të verbitur...

Në faqen 5

PARLAMENT LIGJET

Magjistratët dhe Kodi Rrugor nuk mundën të marrin konsensusin e opozitës

Kuvendi mbyll sot seancën e fundit, ligjet me 84 vota shtyhen për në shtator PD-LSI kushtëzojnë votat për "Teatrin"

Seanca e sotme e Kuvendit do të jetë e fundit për këtë sesion, në pritje të rifillimit javën e tretë të shtatorit. Ky sesion që nisi në janar të këtij viti duket se nuk ka arritur të kalojë me konsensus disa nga projektligjet e rëndësishme. Ndër më të diskutuarit është ligji për Magjistratët dhe ndryshimet në Kodin Rrugor. Në seancën e sotme janë rreth 14 projektligje për miratim, nga të cilat të dy kërkohet 84 vota. Ndërkohë, 12 projektligjet e tjera pritet të miratohen vetëm me votat e socialistëve. Janë tri projektligje për të cilat opozita ka deklaruar se nuk do të bashkojë votat me Partinë Socialiste, duke bërë që ligjet të shtyhen për pas shtatorit. Ligji për emërimin e magistratëve të rinj është ndër më të diskutuarit ditët e fundit për faktin se Partisë Socialiste i duhet me domosdoshmëri votat e të paktën ish-aleatëve të saj, LSI. Nga ana tjetër, përfaqësues të LSI kanë deklaruar mosdakordësi për propozimet e kolegëve socialistë.

Opozita nuk jep votë pro as për ndryshimet e propozuara në Kodin Rrugor, duke bërë që edhe nisma për letësimin e procedurave për marrjen e lejeve të drejtimit të huaja të shtyhet për seancën e pas shtatorit. Të njëjtin fat do e ketë edhe Kodi Ajror. Opozita edhe në këtë seancë të fundit pritet të përsërisë qëndrimin e dy javëve të fundit, ku kërret e dy grupeve parlamentare kërkohet rivotimin e ligjit për shembjen e Teatrit Kombëtar, të cilin maxhoranca e konsideron çështje e mbyllur. Debatit për Teatrin Kombëtar do të vijojë edhe gjatë javëve në vijim. Deri në datën 30 prillit që presidenti të japë vendimin në dekret, ndërsa nga ana e opozitës janë bërë paralajmërime të forta jo vetëm në drejtim të maxhorancës, por edhe ndaj kompanisë ndërtuese. Reforma Zgjedhore është ende larg të shkruarit në letër. Dy bashkëkryetarët kanë kërkuar shtyrje të afatit të komisionit me disa muaj të tjerë, ndërsa dy palët politike ende nuk kanë prekur termat më të rëndësishme të asaj që është premtuar për t'u realizuar, siç mund të jetë ndryshimi i sistemit zgjedhor. Mazhoranca nga ana tjetër ka paralajmëruar ndryshime në ligjin për Partneritetin Publik-Privat. Në shtator pritet që Ministria e Financave të sjellë një nismë të re për ligjin e kon-

cesioneve, për të cilat opozita ka bërë akuza të shumta në drejtim të mazhorancës. Në fokus ndërkohë sërish pritet të jetë trafiku i drogës dhe emrat e akuzuar. Në fuqi

ende vijon të jetë komisioni që heton ish-ministrin e Brendshëm, Saimir Tahiri, i kryesuar nga demokratët. Ky komision në këtë sesion nuk ka prodhuar ende asnjë

rezultat, ndërsa priten informacione nga institucione të ndryshme mes të cilave edhe nga Shërbimi Informativ Shtetëror dhe kryeministria, citon "Report TV".



THIRRJA
Nënkryetarja socialiste e Kuvendit, Vasilika Hysi i bëri thirrje opozitës që të bashkojë votat për emërimin e magistratëve të rinj, por nga ana tjetër opozita ka kthyer përgjigje negative, duke e cilësuar këtë ligj shkelje të Kushtetutës.



Ministri i Jashtëm gjerman, Michael Roth dhe ministri për Europën dhe Punët e Jashtme, Dittmar Bushati gjatë takimit të djeshëm

DIASPORA E EMIGRANTËT

Majko propozon ngritjen e zyrave në çdo njësi vendore

Ministria e Diasporës ka bërë gati një draft me propozime për të ngritur zyrë për emigrantët në çdo Bashki, me qëllim që shqiptarët që jetojnë jashtë vendit të kenë të drejtë për të marrë pjesë në vendimarrjen e qeverisjes vendore. Gjithashtu në këtë draft propozohet që shteti shqiptar duhet t'u japë emigrantëve ndihmë ligjore për regjistrimin dhe pashtetësinë. Vota e emigrantëve prej kohësh vijon të jetë temë e diskutimeve nga komisioni i reformës zgjedhore, nëse do të realizohet apo jo në zgjedhjet e ardhshme parlamentare, apo mënyra se si do të votojnë. Por shqiptarët të cilët jetojnë jashtë vendit po përballen me shumë problematika të tjera, siç është regjistrimi i tyre, pasi ende nuk ka një shifër të sakte, apo pashtetësi, sidomos tek fëmijët me prindër pa dokumentë. Por, Ministria e Diasporës ka propozuar një draft-propozim për ndryshim në ligjin "Për vetëqeverisjen vendore" për t'i sjellë emigrantët dhe diasporën në afër Shqipërisë si dhe vendosjen para përgjegjësisë të shtetit shqiptar. Në këtë draft parashikohet që në të gjitha bashkitë e vendit duhet të ngrihet një zyrë për shërbimet ndaj diasporës dhe emigracionit. "Çdo qytetar apo grupe që përfaqësojnë komunitetet brenda dhe jashtë vendit kanë? të drejtë? t'u drejtojnë ke?rkesa, ankesa apo vërejtje organeve të vetëqeverisjes vendore për çështje që lidhen me funksione dhe kompetenca në juridiksionin e njësisë së vetëqeverisjes vendore". Një tjetër propozim i Ministrisë së Diasporës është që bashkitë duhet të marrin përgjegjësi të drejtë për të dhënë çdo emigrantit ndihmë ligjore për probleme të regjistrimit dhe pashtetësisë. Ministria e Diasporës po punon edhe me Ministrinë e Brendshme për një ligj të ri për shtetësinë për t'u ardhur në ndihmë shqiptarëve jashtë vendit, pasi janë të shumtë ata që nuk kanë një shtetësi.



RENDI I DITËS I SEANCËS SË FUNDIT

1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të datës 19.7.2018 (neni 44, Rregullore).
2. Njoftimi i projektligjeve të depozituara në Kuvend (neni 44, pika 3 e Rregullores).
3. Projektligji "Për kontrollin shtetëror të transferimeve ndërkombëtare të mallrave ushtarake dhe të artikuljeve e teknologjive me përdorim të dyfishtë".
4. Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006, "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", të ndryshuar".
5. Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 69/2012, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" (votim me shumicë prej 3/5 e të gjithë anëtarëve të Kuvendit).
6. Projektligji "Për ndryshimin e marrëveshjes ndërkombëtare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar 2010, për projektin "Rifinancimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në zonat urbane dhe rurale, faza e dytë", ratifikuar me ligjin nr. 86/2015" (votim me shumicë absolute).
7. Projektligji "Për ndryshimin e marrëveshjes ndërkombëtare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar 2010, për projektin "Eficienca energjetike përmes sektorit bankar" ratifikuar me ligjin nr. 89/2015" (votim me shumicë absolute).
8. Projektligji "Për ratifikimin e marrëveshjes financiare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe Cassa Depositi e Prestiti S.p.A., për programin e arsimit dhe formimit profesional nëpërmjet inovacionit" (votim me shumicë absolute).
9. Projektligji "Për ratifikimin e marrëveshjes financiare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe Cassa Depositi e Prestiti S.p.A., për programin e arsimit dhe formimit profesional nëpërmjet inovacionit" (votim me shumicë absolute).
10. Projektligji "Për ratifikimin e marrëveshjes së grantit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për financimin e projektit "Hekurudhat shqiptare - rehabilitimi i linjës hekurudhore Tiranë - Durrës dhe ndërtimi i linjës hekurudhore për në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës", në kuadër të grantit të investimit nga Fondi i Përbashkët Evropian i Ballkanit Perëndimor" (votim me shumicë absolute).
11. Projektligji "Për ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për shtesën e financimit për projektin e modernizimit të asistencës sociale" (votim me shumicë absolute).
12. Projektligji "Për ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për projektin e konektivitetit të rrugëve rajonale dhe lokale" (votim me shumicë absolute).
13. Projektvendim "Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi" (votim me shumicë të thjeshtë).
14. Projektvendim "Për zgjatjen e afatit të veprimit të komisionit të posaçëm të reformës zgjedhore" (votim me shumicë të thjeshtë).
15. Projektrezolutë "Për reformën e politikës shtetërore për diasporën" (votim me shumicë të thjeshtë).
16. Për votim:
- Projektligji "Për profesionin e avokatit të Republikën e Shqipërisë" (votim me shumicë të thjeshtë).
- Projektligji "Për një ndryshim dhe shtesë në ligjin nr. 83/78, datë 22.7.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar" (votim me shumicë prej 3/5 e të gjithë anëtarëve të Kuvendit).
17. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës (neni 45, Rregullore).
Koha e diskutimeve deri në 60 minuta



Ministri i Jashtëm gjerman vjen në Tiranë, do të ketë takim edhe me opozitën

Roth: Kampet e refugjatëve jo kusht, politika të mos rrezikojë negociatat

Bushati: Ka strategji të orkestruar, që mban peng raportet me Greqinë

Darina Tanushi

Ministri i Jashtëm gjerman, Michael Roth i bëri thirrje dje nga Tirana klasës politike shqiptare që të marrë përgjegjësitë dhe të mos pengojë procesin integruar të Shqipërisë. Pas një takimi me ministrin për Europën dhe Punët e Jashtme, Ditmir Bushati, ministri gjerman ka shprehur edhe përgëzimet për vendimin e Këshillit të BE-së për Shqipërinë. Gjatë takimit, siç bëri të ditur ministri Bushati gjatë konferencës për shtyp, është folur për rëndësinë e konsolidimit të reformave, veçanërisht konsolidimi i Reformës në Drejtësi për t'i dhënë vendit një Gjykatë Kushtetuese dhe të lartë siç e meriton, brenda standardeve europiane. "Fokusi i vizitës është rruga e vendit tonë drejt Bashkimit Europian. Një rrugë që është skicuuar nga ana e vendeve anëtare të BE, në kuadër të procesit të bisedimeve për anëtarësimin. Në këtë kontekst, dua t'ju falënderoj edhe njëherë tjetër ju dhe qeverinë gjermane për mbështetjen e pakursyer që i kemi dhënë Shqipërisë, jo vetëm në procesin e vështirë të reformave që kemi ndërmarrë, por kryesisht dhe për diskutimet dramatike, që u zhvilluan në Luksemburg, ku vendi juaj dhe ju ishit pjesë e asaj mazhorancë të madhe të vendeve të BE-së në mbështetje të nisjes së bisedave për anëtarësimin e vendit tonë", tha Bushati. Duke folur për nisjen e procesit të "Screening", Bushati tha se ai ka një rëndësi tejet të madhe. "Ndërmjet pikëpamjen se viti para nesh është një rrugë me sfida, është një vit i rëndësishëm dhe aspak i lehtë. Kemi një pasqyrë të qartë të sfidave që shtrohen para nesh. Në planin e brendshëm duhet të konsolidojmë reformat për sundimin e të drejtës, luftën kundër krimit të organizuar, korrupsionit, thellimin dhe konsolidimin e vetingut dhe ngritjen e institucioneve të reja në kuadër të Reformës në Drejtësi dhe drejtësisë në tërësi. Këto nuk bëhen brenda një periudhe të shkurtër, brenda 3 muajsh, 6 muajsh apo 1 viti apo 2 viteve, por kur të realizohen duam që shtypet të pyeten për cilësinë e jetës dhe të ndjehen ndryshimin e cilësisë së drejtësisë në vend. Ne, në kuadër të reformës në drejtësi



Gjatë konferencës për shtyp

REFORMAT

"Me procesin e vetingut, Shqipëria ka ecur në një rrugë ku nuk e ka shqoq në rajon. Fakti që deri më tani gjykatës dhe prokurorë janë shkëputur nga sistemi tregon se rjerëzitet e kanë kuptuar që qeveria është e vendosur. Këto reforma duhet të vazhdojnë. Duhet të kemi një rrugë të rinj për të mbushur ato pozicione, sepse një sistem gjyqësor që nuk funksionon, ndikon në fusha të tjera të jetës", tha dje Roth.

si duam t'i japim Shqipërisë Gjykatën Kushtetuese dhe Gjykatën e Lartë që meriton", tha Bushati.

MINISTRI GJERMAN

Gjatë fjalës së tij, ministri gjerman i bëri thirrje opozitës që të votojë ligji e "Magjistratëve" dhe të ndihmojë qeverinë në rrugën drejt BE-së. "Unë kam ardhur sot këtu për të shprehur vlerësimin për mikpritjen. Shqipëria është në një rrugë të mirë drejt BE. Ka marrë një rekomandim pozitiv. Nëse çdo gjë ecën në këtë

mënyrë, kjo rrugë do të bëhet realitet. Në radhë të parë bëhet fjalë për krijimin e një shteti ligjor kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit. Me procesin e vetingut, Shqipëria ka ecur në një rrugë ku nuk e ka shqoq në rajon. Fakti që deri më tani gjykatës dhe prokurorë janë shkëputur nga sistemi tregon se rjerëzitet e kanë kuptuar që qeveria është e vendosur. Këto reforma duhet të vazhdojnë. Duhet të kemi një rrugë të rinj për të mbushur ato pozicione sepse një

sistem gjyqësor që nuk funksionon ndikon në fusha të tjera të jetës. Dhe ky proces kërkon një masë të madhe të vetëdijes nga ana e qeverisë, por edhe nga opozita. Ndaj unë do t'ju apeloja që të marrin përgjegjësitë e tyre në mënyrë që të mos e rrezikojnë procesin e Shqipërisë", tha Roth. Ndërkohë që për çështjen e refugjatëve Roth u shpreh se Shqipërisë nuk i është vendosur asnjë kusht pasi ata janë të interesuar që të gjitha palët të gjejnë një zgjidhje të përbashkët. "Nuk ka asnjë kusht që ne i kemi vendosur Shqipërisë për mbylljen e kufijve sa i përket rrymës së emigrantëve apo për hapjen e kampeve të pritjes. Nuk ka lidhje të drejtpërdrejte të kësaj problematike me çështjen e integritimit. Ne jemi të interesuar të gjitha palët që të gjejnë zgjidhje të përbashkët, pa neopiane për emigrantët dhe azilkerkuesit. Bazat në gjetjen e këtyre zgjidhjeve do të ishin vlerat që na bashkojnë ato të solidaritetit dhe humanizimit dhe në këtë kontekst Shqipëria dhe Maqedonia janë të mirëpritura të japin kontributin e tyre", tha Roth.

NEGOCIATAT ME GREQINË

Sa u përket negociatave me Greqinë, i pyetur nga gazetarët, Bushati tha: "Ne jemi në një dialog intensiv me Greqinë, koha është e rëndësishme në marrëdhëniet ndërkombëtare, në disa raste është kritikë. Kemi hedhur hapa substanciale për disa çështje që konsideroheshin deri para pak vitesh tabu. Jemi në tryezë qoftë për kufizimin e zonave detare, ashtu edhe përsa u përket çështjeve që kanë të bëjnë me menaxhimin e kufirit tokësor, menaxhimin e incidenteve kufitare dhe piramidave. Po nga ana tjetër për fat të keq shohim qartë dita-ditës që ka një strategji të orkestruar për ta mbajtur peng dhe për të mos lejuar që marrëdhënia shqiptaro-greke të çlirojnë energjinë që ajo mundet". "Mendoj se të gjithë aktorët politikë kanë nevojë të sillen me përgjegjshmëri sa i përket kësaj dosje. Nuk e di nëse ka një strategji të mirëpërcaktuar apo është koidcidence fakti që si opozita në Greqi dhe ajo në Shqipëri ndajnë të njëjtin qëndrim për këtë çështje. Fakti që ka kundërshtime si në Shqipëri dhe Greqi me atë që po bëjmë në palën greke jemi në rrugën e duhur", tha Bushati.



Vasili, ambasadorëve Lu e Vlahutin: Reforma në drejtësi dështoi, tani heshtni

Kreu i grupit parlamentar të LSI-së Petrit Vasili aku SHBA-së dhe atë të BE-së se u bënë palë me qeverinë për të shkatërruar reformën në drejtësi. Përmes një statusi në "Facebook", Vasili shkroi dje se reforma në drejtësi nga shpresë për shqiptarët u kthye në zhgënjim. Ai thotë se ambasadorët u bënë palë me qeverinë dhe tani i fton të heshtin. "Tani gjëja e vetme që u ka mbetur është që të heshtin, pasi çdo sugjerim në anglisht, kroatisht apo shqipe e çalë vetëm pengon zgjidhjen dhe shuan shpresën", - thotë ai. "Ndërkombëtarët heshtën, kur rilindja përbuzi ONM për anëtarët e KLGJ dhe KLP dhe reforma u kthye nga shpresë në zhgënjim. Rilindja përbuzi dhe hodhi poshtë muaj më parë sugjerimet e Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit të reformës në drejtësi. Ambasadorët e BE dhe SHBA në Tirane deklaruan me zë shumë të lartë se ONM do të ishte garancia e integritetit të reformës, pasi ajo ishte përbërë nga juristë me integritet shumë të lartë nga SHBA dhe BE", u shpreh kreu i grupit parlamentar të LSI-së. Sipas tij, "Rilindja duke përbuzur ONM rrënoi pra reformën dhe integritetin e saj. Asnjë nga ambasadorët nuk foli asnjë fjalë përpara këtyri atentati juridik e moral, që po i bëhej reformës. Pra, reforma u fut në qorr-sokak dhe atë tanimë nuk e beson më kurrkush, ajo thjesht ndërroi pronarin, duke kthyer drejtësinë në pronë të rilindjes. Heshnja e dënueshme e djeshme u ka humbur të huajve sot mundësinë që ata të flasin, të preokupojnë dhe të sugjerojnë. Ambasadorët u trembën që t'i tregojnë vendin dhe t'i drejtojnë gishtin rilindjes si fajtorja dhe shkakhtarja e vetme, që reforma në drejtësi nga shpresë u kthye në zhgënjim. Të huajt e humbën pra momentin dhe zhvlerësimi i tyre është zgjedhja e tyre për të qenë njësh me qeverinë për kapjen e reformës në drejtësi. Tani gjëja e vetme që u ka mbetur është që të heshtin pasi çdo sugjerim në anglisht, kroatisht apo shqipe e çalë vetëm pengon zgjidhjen dhe shuan shpresën".

"Magjistratët", Manjani: Projektligji është mashtrim e legalizim i korrupsionit

Projektligji që propozon Rilindja për kuotat e Shkollës së Magjistraturës, me gjithë propozimet e bëra nga ata që kanë mbetur ende në delegacionin e BE dhe ambasadorin e SHBA, është antireformë dhe legalizim i korrupsionit", theksoi dje ish-ministri i Drejtësisë, Ylli Manjani. Në një postim në "FB" ai sqaroi se ky projektligj "është antireformë sepse: 1. Sipas ligjeve të reja kuotat e magistratëve që duhet të shkollohen i përcakton KLGJ dhe KLP. Në kundërshtim me këto ligje, Rilindja propozon që kuotat i caktojë parlamenti. 2. Miratimi i kuotave nga Parlamenti do të thotë legalizim i moskrijimit të KLGJ dhe KLP. Të dyja këto organe janë motori i zbatimit të reformës. Pra, nuk është vetingu, as Shkolla Magjistraturës. Jo! Është krijimi i KLGJ dhe KLP. Nëse detyrat e tyre do t'i kryejë Kuvendi, tamam si me ligjin e prishjes së teatrit, atëherë nuk ato krijohen. Të paktën tani shpejt". Me këtë projektligj Rilindja kërkon të hedhë hi syve opinionit. Shtija që i bën këtë projekt si "zgjidhje e vakumit në drejtësi", është mashtrim. Ky projekt nuk zgjidh fillimin e funksionimit të Gjykatës së Lartë dhe asaj Kushtetuese. Ky ligj nuk zgjidh as krijimin e SPAK e as të Byrosë së Hetimit. As çështjen e Prokurorit të Përgjithshëm e as të Inspektorit të Përgjithshëm. Asnjëherë nga këto. Pra është mashtrim", tha dje Manjani.

Spaho, letër Ruçit: Procesi drejtohet nga ministri i lidhur me krimin

Kryetari i grupit parlamentar të PD, Edmond Spaho sqaron në një letër drejtuar kryetarit të Kuvendit, arsytet përse PD e konsideron farsë dhe nuk do të çojë anëtarët e saj në nënkomisionin parlamentar që mbikëqyr vettingun në polici. Në letër thuhet se "ligji është një mekanizëm fasadë i qeverisë, që me propagandë, të mbulojë lidhjet e qeverisë me krimin e organizuar, të mbajë nën kontroll politik dhe të realizojë spastrime politike në Policinë e Shtetit". Argumenti kryesor që zoti Spaho përmend në letër dhe që provon farsën e vettingut në polici ishte mospranimi nga mazhoranca i propozimit thelbësor të PD, që vettingu në radhët e Policisë së Shtetit të fillojë nga drejtuesit politikë, duke nisur me ministrin e Brendshëm. "Sa kohë procesi i vettingut drejtohet nga një ministër i Brendshëm, i lidhur me krimin e organizuar dhe që nuk pranon që vetë të jetë subjekti i procesit të vettingut, opozita e konsideron këtë proces një farsë të papranueshme, ku nuk mund të bëhet pjesë", thotë kreu i deputetëve demokratë, Edmond Spaho. "Problemi themelor i Policisë së Shtetit sot nuk është moskryerja e 'vettingut' ndaj punonjësve të thjeshtë të Policisë së Shtetit, por mungesa e mbështetjes nga qeveria të punonjësve të ndershëm të Policisë së Shtetit dhe lidhja e qeverisë me krimin e organizuar. Nëse do të kishte vullnet politik për largimin e punonjësve të korruptuar apo të lidhur me krimin, për këtë nuk ka nevojë të miratohet një ligj i posaçëm për vetting në polici, por do të mjaftonte baza ligjore që ishte në fuqi dhe zbatimi rigoroz i ligjit për Policinë e Shtetit", thuhet në letrën e Spahos. Sipas tij, "problematikat e rënda që po kalon sot Policia e Shtetit nuk zgjidhen me vetting fasadë ndaj punonjësve të thjeshtë të Policisë së Shtetit, por me vetting ndaj drejtuesve politikë të Ministrisë së Brendshme, që janë autorët e kriminalizimit të segmenteve të caktuara të Policisë së Shtetit. Për këtë qëllim, në kohën e miratimit të ligjit, kemi propozuar që vetingu në radhët e Policisë së Shtetit të fillojë nga drejtuesit politikë, duke nisur me ministrin e Brendshëm. Kjo kërkesë e jona nuk u pranua, duke provuar në këtë mënyrë farsën e këtij procesi". "Për grupin parlamentar të Partisë Demokratike është e papranueshme që sipas ligjit, një punonjësi i thjeshtë i Policisë së Shtetit konsiderohet si i papërshtatshëm me detyrën për shkak se një kushëri i tij është i dënuar më parë, ndërkohë që drejtuesi politik, ministri i Brendshëm, konsiderohet i përshtatshëm dhe vijon

PD: Nënkomisioni për vettingun në polici farsë, nuk marrim pjesë

"Kontrolli të nisë nga ministri i Brendshëm"



Kryetari i grupit parlamentar të PD, Edmond Spaho

Ministrisë së Brendshme, vijmësisht nga ministri të lidhur me trafikun e drogës dhe krimin e organizuar, është modeli që ka shkruajtur punonjësit e ndershëm të Policisë së Shtetit dhe është pikërisht kjo arsye që e bën fasadë procesin e rivlerësimit të punonjësve të policisë. Pyetja normale që bën sot çdo shqiptar është sesi një ministër i Brendshëm që ka vëllain në burg dhe të dënuar për krim të organizuar, i kërkon një punonjësi të thjeshtë të policisë që të lërë detyrën për shkak se ka vëllain e dënuar për një kundërvajtje penale". "Në këtë kuptim, sa kohë procesi i vettingut drejtohet nga një ministër i Brendshëm i lidhur me krimin e organizuar dhe që nuk pranon që vetë të jetë subjekti i procesit të vettingut, opozita e konsideron këtë proces një farsë të papranueshme, ku nuk mund të bëhet pjesë", përfundon letra e ffirmosur nga Spaho.

detyrën, edhe pse ka kontakte të papërshtatshme me krimin e organizuar, sepse më së paku ka pasur dhe ka kontakte me vëllain e tij të dënuar dhe në burg për trafik ndërkombëtar droge dhe pjesëmarrje në organizatë kriminale", vijon shkresa e PD-së. Sipas kësaj partie, "ky model i drejtimit të

Zv.kryeministrja Mesi takon diasporën në Nju Jork: Të gatshëm të bashkëpunojmë

Zv.kryeministrja Senida Mesi, gjatë vizitës disaditore në Nju Jork u takua edhe me përfaqësues të diasporës shqiptare. Pas këtij takimi, ajo shkroi në profilin e saj në "Facebook": "Emocion i veçantë ishte takimi me përfaqësues të diasporës shqiptare në Amerikë, takim i organizuar me mbështetjen e Shoqatës së Grave Shqiptaro-Amerikane Motrat Qiriazit". Pata rastin të takoj tek e tek çdo pjesëmarrës e të njehesha personalisht me arritjet e secilit në fushat ku punojnë dhe kontributin e tyre në komunitet e më gjerë. Shumë krenare për këta individë që me punë, pasion e përkushtim lartësojnë dita-ditës emrin shqiptar!", u shpreh zv.kryeministrja Mesi. Ajo shtoi se "gjatë takimit i sigurova të pranishmit për gatshmërinë e qeverisë shqiptare për t'u angazhuar me përkushtim në drejtim të bashkëpunimeve të frytshme me çdo shoqatë, organizatë apo pjesëtar me kontribut në diasporën shqiptare!".

PROCESI
Tashmë janë përzgjedhur 30 komisionerët që do të kryejnë vettingun në Policinë e Shtetit. Ka përfunduar gara dhe aktualisht janë 5 komisionerët të Vlerësimit të Jashtëm të Përzgjedhur, 15 anëtarë të sekretariatit teknikë, 5 anëtarë të përzgjedhur nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit të Pasurive dhe 5 përfaqësues nga bota akademike nga Universiteti i Tiranës.

Deputeti i PD-së akuzon kryeprokuroren, e quan "PPP e Ramës"

Paloka: Arta Marku u zgjodh në krye të prokurorisë për të mbyllur dosjet

Deputeti i PD-së, Edi Paloka akuzoi dje kryeprokuroren Arta Marku se ka ardhur në atë detyrë vetëm për të mbyllur dosjet. Përmes një postimi në rrjetin social "Facebook", Paloka e quan Prokuroren e Përkohshme të Përgjithshme "PPP-në e Ramës". Sipas tij, Arta Marku nuk i është përgjigjur pyetjes së tij në Komisionin e Ligjeve nëse ka dosje të hapura të ministrave socialiste. Paloka tha se Arta Marku u zgjodh në krye të prokurorisë për të mbyllur dosjet e ministrave dhe kryebashkiakëve socialistë dhe nuk përgjigjet për këto dosje. "A i ka zhdukur PPP'ja e Ramës në prokurori dosjet e ministrave dhe kryebashkiakëve socialistë? Gjatë raportimit të Markut në Komisionin e Ligjeve, pyetja e parë që unë i drejtova ishte: 'A keni dijeni ju nëse Prokuroria e Krimeve të Rënda ka pasur në hetim dhe përgjim ministra, de-



putetë dhe funksionarë të PS? Çfarë është bërë me ato dosje? Përgjigja edhe për këtë pyetje si për gjithë të tjerat ishte 'Nuk e di'", u shpreh Paloka. Sipas tij, "ajo që u vu prej Ramës në kundërshtim me Kushtetutën, në krye të Prokurorisë së Përgjithshme e që u akuzua që ditën e parë nga opozita se po dërgohej aty pikërisht për të mbyllur dosjet e ministrave socialistë, 'nuk e dinte' nëse kishte dosje të hapura për ministra socialistë...". Paloka ngre pyetjen se pasi u pyet në Komisionin e Ligjeve a u interesua të dijë, Arta Marku. "Dje është akuzuar direkt nga lideri i opozitës se bashkë me të emëruarën e saj në Prokurorinë e Krimeve të Rënda i kanë zhdukur këto dosje! Do përgjigjet PPP'ja apo ajo vetëm firmën ve aty ku i tregojnë shenjë?", u shpreh Paloka.

United Nations Development Programme

TENDER ANNOUNCEMENT

Subject: Request for Quotation - Furniture for Multifunctional Community Centre in Shkodra City

The United Nations Development Programme in Albania is seeking to receive quotations from interested companies who wish to be considered for the provision of the below mentioned furniture's.

Furniture for Multifunctional Community Centre in Shkodra City - ESERE

Companies will be selected in accordance with pre-established UNDP procedures. The offers must be delivered within the deadline set in a sealed envelope and with clearly marked for "UNDP - Economic and Social Empowerment for Roma and Egyptians - ESERE" to the address below.

For more details please refer to the link below:
<http://www.al.undp.org/content/albania/en/home/operations/procurement.html>

Relevant Dates: All interested companies should provide their application in the following address, not later than August 03, 2018, 14:00 hrs.

Any request for Clarifications must be sent to the following e-mail address: procurement.al@undp.org

Address for Communication:
UN House Albania
Str. "Skenderbej", Gurten Building, 2nd Floor
Tirana, Albania
Tel.: + (355) 4 2 276 600
Fax: + (355) 4 2 234448

Dokumentet që duhet të plotësojë mosha e tretë për të përfituar 648 lekë në muaj

Kompensimi i energjisë, dokumentet dhe aplikimi për pensionistët

Personat duhet të vetëdeklarojnë për të përfituar

Ornela Manjani

Pensionistët që duan të përfitojnë kompensimin për energjinë elektrike, i caktuar në masën 648 lekë në muaj duhet të plotësojnë pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore formularin-tip. Kompensimi i energjisë elektrike për efekt të heqjes së fashës mbrojtëse prej 300 kwh në muaj përfitohet nga familjet me ndihmë ekonomike, kryefamiljarët në pensione pleqërie e invaliditeti, familjet që kanë në përbërje persona me aftësi të kufizuara, të verbrit, paraplegjikët e tetraplegjikët dhe punonjësit buxhetorë me pagë nën 35 mijë lekë në muaj.

Personat që marrin pension rishtas duhet të plotësojë bënë kërkesën dhe plotësojnë formularin kur marrin pensionin, ndërsa pensionistët që marrin aktualisht kompensimin duhet të presin njoftimin e ISSH-së për të përsëritur dokumentet.

PËRFITUESIT

Përfituesit janë kryefamiljarët që përfitojnë pension pleqërie shtetëror, pension pleqërie fshati ose pension social, por që janë me banim në qytet dhe nuk kanë anëtarë të familjes të punësuar ose të vetëpunësuar. Janë përfitues kryefamiljarët që përfitojnë pension pleqërie ose pension social që janë me banim në fshat, kur familja përbëhet vetëm nga pensionistët.

Gjithashtu kompensim përfitojnë pensionistët në rastet kur në të njëjtën familje ka dy pensionistë të vetëm dhe kontrata është në emër të pensionistit jokryefamiljar, kompensimin e përfiton pensionisti në emër të të cilit është kontrata e energjisë elektrike. Në rastet kur si e ardhur e vetme e familjes është pensioni familjar dhe kontrata është në emër të kryefamiljarit pasjetues, të fëmijëve ose në emër të kryefamiljarit të vdekur, kompensimi u akordohet personave përfitues të pensionit familjar.

VETËDEKLARIMI

Për të përfituar personat duhet të bëjnë një vetëdeklarim, pasi vetëm në këtë mënyrë mund të marrin paratë. Kjo sipas një vendimi qeverie që rregullon mënyrën e për-



fitimit e ku saktësohet se kjo procedurë zhvillohet pranë institucioneve përkatëse në të cilat përfituesit marrin pagën, pensionin apo përfitimet e tjera. "Përfituesit që kompensohen për të përballuar rritjen e çmimit të energjisë elektrike, si rezultat i heqjes së fashës deri në 300 kwh, do të përcaktohen nga institucionet përkatëse në të cilat ata marrin pagën, pensionin dhe përfitimet e tjera, kundrejt deklarimit të tyre personal.

Marrja e përfitimit pa deklarim dhe kundrejt deklarimit të rremë përbën shkelje administrative, përkatësisht përdhënesin dhe përfituesin e kompensimit. Në këtë rast, institucioni përkatës zbaton dispozitat ligjore në fuqi", thuhet ndër të tjera në vendim, ndërsa theksohet se ata persona që do të bëjnë deklarim të rremë, do të detyrohen ta kthejnë përfitimin e padrejtë si dhe do të përjashtohen përgjithmonë nga e drejta e përfitimit të kompensimit për energjinë elektrike.

Aktualisht, kompensim të diferencës së çmimit të energjisë elektrike përfitojnë të gjitha familjet që trajtohen me ndihmë ekonomike, si dhe familjet që kanë në përbërje anëtarë me aftësi të kufizuara. Po ashtu, kompensim përfitojnë edhe kryefamiljarët që përfitojnë pension invaliditeti shtetëror dhe pension invaliditeti të plotë në fshat, si dhe familjet e punonjëseve buxhetorë, me pagë mujore bruto nën 35 000 (tridhjetë e pesë mijë) lekë në muaj, kur punonjësi është kryefamiljar.

Kushti për të përfituar kompensim për këto kategori është që personi të mos ketë asnjë anëtar të familjes të punësuar ose të vetëpunësuar. Nderkaq, dy kategoritë e fundit që kompensohen për energjinë elektrike janë të verbrit si dhe personat paraplegjikë e tetraplegjikë.

KOMPENSIMI PËR MBROJTJEN E SHTRESAVE NË NEVOJË PËR EFEKT TË HEQJES SË FASHËS SË KONSUMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, DERI NË 300 KWH NË MUAJ

Kompensimin e shpenzimeve nga ndryshimi i çmimit të energjisë elektrike në masën 648 lekë e përfitojnë të gjitha kategoritë e pensioneve, si më poshtë:

- Kryefamiljar në pension pleqërie shtetëror ose fshati, por me banim në qytet.
- Kryefamiljar në pension invaliditeti.
- Nuk ka anëtarë të familjes të punësuar ose të vetëpunësuar, jeton vetëm, ose ka fëmijë në ngarkim pa të ardhura.
- Ka kontratë me OSHEE-në (shënuar në faturën e shitjes apo librezën e dritave në emër të tij).
- Nuk ka dysheme për konsumin e energjisë elektrike.
- Nuk ka detyrime të papaguara të energjisë elektrike.

I) FAMILJET, TË CILAT TRAJTOHEN ME NDIHMË EKONOMIKE, FAMILJET QË KANË NË PËRBËRJE ANËTARË ME AFTËSI TË KUFIZUARA, TË VERBËR DHE PARAPLEGJIKËT E TETRAPLEGJIKËT. Për familjet që trajtohen me ndihmë ekonomike, administratori shoqëror i njësisë së qeverisjes vendore harton listën emërore të personave që

përfitojnë këtë kompensim. Për përfitimin e këtij kompensimi, aplikuesi duhet të paraqesë pranë administratorit shoqëror:

- Fotokopje të nënshkruar të kartës së identitetit.
 - Certifikatën familjare.
 - Fotokopje e librezës së energjisë elektrike që vërteton se nuk ka detyrime të papaguara.
- 2. Familjarët që kanë në përbërje anëtarë me aftësi të kufizuara, kur personi me aftësi të kufizuara është kryefamiljar dhe nuk ka anëtarë të familjes të punësuar ose të vetëpunësuar duhet të paraqesë pranë administratorit shoqëror:**
- Fotokopje të nënshkruar të kartës së identitetit.
 - Certifikatë familjare që vërteton se personi me aftësi të kufizuara është kryefamiljar.
 - Për anëtarë madhorë të familjes, vërtetim nga Zyra e Punës që janë punëkërkuar të papunë.
 - Fotokopje të librezës së energjisë elektrike që vërteton se nuk ka detyrime të papaguara.

3. Të verbrit, paraplegjikët dhe tetraplegjikët duhet të paraqesin pranë administratorit shoqëror:

- Fotokopje të nënshkruar të kartës së identitetit.
- Certifikatë familjare.
- Fotokopje e librezës së lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror ose

fotokopjen e vendimit të KMCAP-it/ KMVP.

- Fotokopje e librezës së energjisë elektrike që vërteton se nuk ka detyrime të papaguara.

Lista e hartuar nga administratori shoqëror miratohet nga Këshilli i Njësisë së Qeverisjes Vendore.

I. KRYEFAMILJARË QË PËRFITOJNË PENSION INVALIDITETI DHE PENSION PLEQËRIE

1. Lista emërore e pensionistëve kryefamiljarë që përfitojnë pension pleqërie ose pension invaliditeti përcaktohet nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe strukturat rajonale në varësi të tij, bazuar në deklaratën personale të përfituesit.

Kryefamiljarit pensionist/invalid duhet të paraqesë pranë agjencive lokale të Sigurimeve Shoqërore të vendbanimit:

- Fotokopje të nënshkruar të kartës së identitetit.
- Certifikatën familjare për invaliditet.
- Për anëtarë madhorë të familjes vërtetimin nga Zyra e Punës që janë punëkërkuar të papunë.
- Fotokopjen e librezës së energjisë elektrike që vërteton se nuk ka detyrime të papaguara.

2. Kompensimi për pensionistët/invalidët realizohet nga qendra e

pagesës së pensioneve sipas gjenerimeve në portalin informatik të pagesave të pensioneve ose mbi bazën e urdhërpagesës së listuar, e cila përgatitet nga strukturat rajonale të ISSH. Dokumentimi i pagesës faktike të kompensimit bëhet me një listëpagesë të veçantë, e cila nënshkruhet nga përfituesi në emër të tij dhe nga qendra paguese/Posta Shqiptare sh.a.

III. KRYEFAMILJARËT QË JANË PUNONJËS BUXHETORË, ME PAGË MUJORE BRUTO NËN 35 MIJË LEKË NË MUAJ

Përcaktimi i përfituesve do të bëhet nga institucionet përkatëse buxhetore, ku përfituesit marrin pagën bruto nën 35 mijë lekë. Në fillim të procesit të përfituesve dhe sa herë që ndryshojnë kushtet për përfitim, personat përfitues të këtij kompensimi së bashku me deklaratën personale duhet të paraqesin pranë strukturës përkatëse të burimeve njerëzore:

- Fotokopje të nënshkruar të kartës së identitetit.
- Certifikatë familjare që vërteton se punonjësi buxhetor është kryefamiljar.
- Për anëtarë madhorë të familjes vërtetimin nga Zyra e Punës që janë punëkërkuar të papunë.

Skeda e pasurisë së deklaruar nga Astrit Faqolli

TIRANË

Gjyqtari i Gjykatës së Tiranës, Astrit Faqolli, do të përballë të hënën me Komisionin e Pavarur të Kualifikimit. Trupi gjykoës që do të kryejë rivlerësimin e tij përbëhet nga Firdes Shuli, Roland Ilija dhe Genta Tafa Bungo. BIRN raporton se Faqolli është bërë pjesë e listës prioritare të vetingut për shkak të kandidimit në Këshillin e Lartë Gjyqësor. Ai e ka nisur karrierën e tij në sistemin e drejtësisë si inspektor në Inspektoratin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ku ka punuar gjatë viteve 2003-2010. Në vitin 2010, Faqolli u emërua gjyqtar në Gjykatën e Durrësit dhe prej vitit 2013 e ushtron detyrën në Gjykatën e Tiranës. Analiza e pasurisë është një ndër tri shtyllat e rivlerësimit për gjyqtarët, së bashku me kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale. Skeda grafike e mëposhtme paraqet ndryshimin e pasurisë së deklaruar të gjyqtarit Astrit Faqolli nga viti 2003 deri në fund të vitit 2017. Ky raport është prodhuar nga BIRN pas administrimit të deklarave të pasurisë së këtij subjekti nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të

Si kanë ndryshuar të ardhurat e gjyqtarit në këto 14 vite

Sot, përballja me Komisionin e Pavarur të Kualifikimit



Gjyqtari i Gjykatës së Tiranës, Astrit Faqolli

Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, ILDKPKI. Ai ka për qëllim bërjen e transparencës mbi pasurinë e gjyqtarëve dhe prokurorëve që i nënshtrohen procesit të vetingut.

Të dhënat e analizuar

nga BIRN tregojnë se gjyqtari Astrit Faqolli zotëron një pasuri prej 2.5 milionë lekësh në vitin 2003, kur deklaroi pasurinë për herë të parë. Në fund të vitit 2017, pasuria familjare e zotit Faqolli është rritur mbi 3

herë, duke kapur vlerën e 9.3 milionë lekëve. Pasuritë e paluajtshme zënë pjesën kryesore me një vlerë prej rreth 8.3 milionë lekësh. Sipas deklaratave periodike të dorëzuara në ILDKPKI, ai zotëron një apartament në

Faqolli është bërë pjesë e listës prioritare të vetingut për shkak të kandidimit në Këshillin e Lartë Gjyqësor. Ai e ka nisur karrierën e tij në sistemin e drejtësisë si inspektor në Inspektoratin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ku ka punuar gjatë viteve 2003-2010.

familjare të gjyqtarit Astrit Faqolli për periudhën 2003-2017 kapin vlerën e 29.8 milionë lekëve. 66 për qind e të ardhurave kanë si burim pagën e tij, 28 për qind pagën e bashkëshortes dhe 5 për qind të ardhurat nga qiraja. Përveç analizës për rritjen/uljen e pasurisë, strukturën e asetëve dhe të ardhurave, ky raport paraqet edhe kontrollin aritmetik/logjik të deklaratimeve të subjektit si dhe "flamujt e kuq", që identifikohen gjatë kontrollit. BIRN kreu kontrollin aritmetik/logjik për 14 vite të deklarimit dhe asnjëra prej deklaratave nuk rezultoi me probleme. BIRN ka evidentuar si "flamur të kuq" faktin që gjyqtari Astrit Faqolli ka marrë hua te të afërmit në shumat 10 mijë euro në vitin 2006 dhe 1 milion lekë në vitin 2011. Të dyja hua janë shlyer plotësisht deri në fund të vitit 2017. Duke qenë se ky raport bazohet në të dhëna statistikore të analizuar nëpërmjet një databaze, ai nuk nxjerr përfundime mbi pasurinë e subjektit nëse ajo mbulohet me burime të ligjshme ose jo, por mëton të informojë publikun mbi pasurinë e deklaruar të zyrtarit publik nëpërmjet një formati të thjeshtë dhe të kuptueshëm grafik.

Press Notice

To the attention of the general public
Make it in Albania – OPENING OF THE SECOND CALL FOR PROPOSALS

Following its mandate from the German Federal Ministry for Economic Cooperation and Development (BMZ) and in partnership with the Ministry of Economy and Finance (MoEF), the GIZ Program for "Sustainable Economic and Regional Development, Employment Promotion and Vocational Education and Training" in Albania (GIZ ProSEED) under its third component of Social Participation of Marginalized Youth and Minorities is opening its **Second Call for Proposals from 23 July – 21 August 2018**.

The aim of this call for proposals is to financially support local civil society organizations, to implement small-scale projects that strengthen social empowerment and cohesion, and enable the target group to engage actively, in line with their interests and capabilities, to find common solutions to improve their-, and their respective communities' social and economic situations.

All CSOs registered in Albania with at least 2 years of relevant experience and proven record in youth empowerment and social cohesion are invited to submit proposals under this call for proposals.

The 10 envisaged proposals to be selected through this competitive call shall receive financial support in the amount between 10,000 – 20,000 EUROS (equivalent in ALL).

The proposed interventions submitted by the local CSOs may take different shapes and may include activities that strengthen the interaction between different groups of youth, activities that contribute to the development of life skills, cultural and sports activities, as well as activities that foster the inclusion of minorities, women, persons with disabilities and migration returnees. The long-term outcome of these activities should aim at increasing the target group's social capital and future employability prospects.

In order to submit a proposal for participation in this call, it is necessary to consult the Application Guidelines that may be obtained by it through the ProSEED Facebook page. The Application Guidelines state the defined objectives, and requirements to be complied with and provide detailed information on the procedures for selection. Interested local CSOs can find all the official templates for submitting proposals under this call annexed to these guidelines. Applying CSOs shall submit their applications only electronically to makeitinitalbania@giz.de. All applications must be submitted in English language.

For further questions and clarifications on the Application Guidelines, please contact us via email to: makeitinitalbania@giz.de during the period **16 – 20 of July 2018**, prior to the opening of the call. After this period GIZ ProSEED shall not answer any enquiry related to the call.

The deadline for the submission of the proposals is 21 August 2018, 16:00h.

ANNOUNCEMENT

Private Vocational Training Providers – Call for (i) Expressions of Interest and (ii) Proposals

The GIZ Program for "Sustainable Economic and Regional Development, Employment Promotion and Vocational Education and Training" in Albania (GIZ ProSEED), implemented on behalf of the German Federal Ministry of Economic Cooperation and Development, under the component of Technical Vocational Education & Training (VET), will cooperate with private vocational training providers in the country with the aim to scale-up VET interventions, complementary to the courses offered by public VET providers.

In this respect, the programme is conducting a Call for (i) Expressions of Interest and (ii) Proposals from **23 July – 20 August 2018**, which shall help to identify private training providers that offer Vocational Training (VT) in line with the requirements below:

- Under each contract, the private training providers, will offer several training courses. The training duration of each course per batch should be at least 1 month.
- The training courses under each contract should target altogether 50-150 young people (19-34 years) in total. 40% of the participants are to be female and 30% are to be returning migrants from EU Member States.
- The courses should reflect the following prioritized sectors: ICT, tourism, agro-processing, textile & footwear and innovative/creative crafts; but are not necessarily limited to these sectors, if justified based on local labour market needs and employment prospects.
- The courses should be demand-driven and include work-based learning based on local labour market needs and eventually aim at employment.
- The proposals should reflect and include information on job placement mechanisms to guarantee employment of minimum 50% of the participants.
- There is no limitation in terms of geographical location, though priority will be given to (rural) locations where public/private vocational training is non-existent or very limited.
- The overall implementation timeframe for the interventions is up to 9 months.

The proposals that are to be selected through this call shall receive financial support ranging between 30,000 – 50,000 EURO (equivalent in ALL). The number of contracts is flexible until the overall programme budget of EUR 400,000 assigned for this activity is allocated.

Selection Procedure:

First step: All (i) Expressions of Interest and (ii) Proposals received by applicants will be evaluated based on the eligibility and technical criteria described in the evaluation grid.

Second Step: The potentially qualified candidates will be invited for interviews and required to submit a budget proposal.

Third Step: Contracts will be awarded to the companies with best technical and financial offer.

Please, send an email to giz-albanien@giz.de, to receive the Proposals format and the Evaluation Grid.

For further questions contact us via email to giz-albanien@giz.de during the period 23 July – 20 August 2018.

Dëshmia e punonjësve në Levan: Ja si morën paratë në kasafortë dy të rinjtë

Grabiste me armë karburantet bashkë me kushëririn, arrestohet 31-vjeçarja Anna Malaj

Policia: Dy autorët bastisnin gjatë orëve të natës, e reja vepronte me gjakftohtësi

Ervis Kuçi

FIER

Një grua 31-vjeçare, e cila ishte kthyer në tmerrin e karburanteve në Fier dhe në Mallakastër ka përfunduar në prangat e policisë. Bëhet fjalë për Anna Malajn, e cila së bashku me kushëririn e saj 22-vjeçar E.G. kanë grabitur brenda harkut kohor të dy javëve një pikë karburanti, ndërsa kanë tentuar që të grabisin dhe dy të tjerë, por kanë dështuar. E reja simpatike nga fshati Visokë i Mallakastërs, sipas burimeve zyrtare nga policia e Fierit vepronte me gjakftohtësi. Kjo referuar tri rasteve, një e finalizuar me grabitje dhe dy të tjerat të mbetura në tentativë. Po të njëjtat burime pohuan se Anna vishte dorezat e maskohej dhe nisej gjatë orëve të natës të gjente prenë e radhës. Mësohet se 31-vjeçarja dhe kushëririn i saj përdornin një armë gjahu dhe një automjet, të cilit i vendosnin targa të vjedhura. Dy kushërinjtë akuzohen për "Vjedhja me armë", e kryer në bashkëpunim e mbetur në tentativë" dhe "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve dhe municionit luftarak", vepra penale që parashikojnë dënim deri në 10 vite burg. Policia nuk ka dokumentuar ende ngjarje të tjera ku mund të jetë përfshirë Anna Malaj, ndërsa pritet dëshmia e saj para bluve. Ende nuk dihet nëse ishte vetë Anna ideuesja e së gjithë skemës së grabitjes, apo kushëririn i saj 22-vjeçar që është shpallur në kërkim.



31-vjeçarja e arrestuar, Anna Malaj



Materialet e sekuestruara nga policia

AKUZAT

Dy kushërinjtë akuzohen për "Vjedhja me armë", e kryer në bashkëpunim e mbetur në tentativë" dhe "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve dhe municionit luftarak", vepra penale që parashikojnë dënim deri në 10 vite burg. Policia nuk ka dokumentuar ende ngjarje të tjera ku mund të jetë përfshirë Anna Malaj. Ende nuk dihet nëse ishte vetë Anna ideatorja e së gjithë skemës së grabitjes, apo kushëririn i saj 22-vjeçar që është shpallur në kërkim.



Banesa e familjes Malaj në Mallakastër

GRABITJET DHE ARRESTIMI

Specialistët e seksionit për hetimin e krimeve kundër pronës dhe pasurisë në Drejtorinë Vendore të Policisë Fier, falë punës operative e hetimore të mirëorganizuar kanë bërë të mundur zbardhjen e tri ngjarjeve të ndodhura këtë muaj në këtë qark, ku dy persona nën kërcënimin e armës, gjatë orëve të vona të natës shkonin për të vjedhur pika të ndryshme karburantesh. Pas hetimeve të kryera, blutë arrestuan Anna Malajn, banuese në fshatin Visokë, Mallakastër. Ndërsa materialet u referuan në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier dhe po punohet për kapjen e shtetasit: E.G., 22 vjeç, banues në fshatin Belinë të Patosit. Sipas hetuesve të çështjes, dy kushërinjtë nën kërcë-

imin e armës, në datën 02.07.2018, në Levan, kanë vjedhur një pikë karburanti ku kanë marrë shumën prej 30.000 lekësh të reja. Në datën 07.07.2018, në Mallakastër, nën kërcënimin e armës kanë tentuar të vjedhin një pikë karburanti, por pasi janë ndeshur me punonjës të karburantit, janë larguar. Në datën 15.07.2018, në lagjen "1 Maji" Fier, në bashkëpunim, duke kërcënuar me armë gjahu teke, kanë tentuar të vjedhin një tjetër pikë kar-

buranti. Ndërkaq, policia ka sekuestruar në cilësinë e provës materiale automjetin me të cilën shkonin në vendngjarje, 1 armë gjahu teke dhe 6 fishekë, 1 palë doreza si dhe 4 targa mjete të falsifikuara.

DËSHMIA E PUNONJËSVE

31-vjeçarja Anna Malaj dhe kushëririn i saj kanë mundur të grabisin me 2 korrik të këtij viti pikën e karburantit në aksin rrugor Fier-Levan. Punonjësit e karburantit kanë zbardhur

Banorët: Është e martuar, i shoqi është në emigrim

Kush është Anna Malaj, grabitësja "sexy" e karburanteve

FIER - Ndërkaq, "Gazeta Shqiptare" ka mundur të zbardhë detaje të reja mbi jetën e grabitësës "sexy". Mësohet se 31-vjeçarja është e martuar në Fier, ndërsa bashkëshorti punon prej vitesh në emigrim. Gjithashtu, bëhet me dije se grabitësja ka ndryshuar emrin nga Jonida në Anna rreth



vitet 2014. "GSH" ishte dje në banesën e familjes së Anna Malaj, por askush nuk u

pronouca në lidhje me arrestimin e saj. Vila 3-katëshe ndodhet në fund të një rrugice, në majë të një kodre, por dera e saj mbyllet me shpejtësi. Ndonëse familjarët kyoqën gojë, banorët të fshatit i u shprehën se prej kohësh prindërit e saj jetonin në Greqi.

Vodhi bizhuteri e sende me vlerë në shtëpinë e xhaxhait, pranga të riut

TIRANË - Policia e Tiranës ka arrestuar në flagrancë një 31-vjeçar, pasi akuzohet se ka vjedhur disa sende me vlerë në banesën e xhaxhait të tij. Burime zyrtare nga blutë e kryeqytetit bënë me dije se i riu me inicialet G.D., akuzohet se ka vjedhur disa bizhuteri floriri dhe një aparat fotografik në shtëpinë e shtetasit me inicialet A.D. "Më datë 21.07.2018, u arrestua në flagrancë shtetasi G.D. vjeç 31, banues në Tiranë, pasi në banesën e xhaxhait A.D. vjeç 62, ka vjedhur disa bizhuteri floriri dhe 1 aparat fotografik. Materialet në ngarkim të tij u përcollën për hetime të mëtejshme prokurorisë", thuhet në njoftimin zyrtar të policisë.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
Zyra përbarimore "Best 2010"

SHPLLALLE ANKANDI

Më datë 17 gusht 2018 nga ora 08.00-ora 16.00 tek kjo zyre përbarimore do zhvillohet ankandi për shitjen e pasurisë nr.58/56, vol 17, fq 3 të ndodhur në L.13, ZK 8518, Plazh, Durrës. Truali që ka sipërfaqen prej 600 m² kufizohet sipas një marrëveshje sipërmarje.

Prona është e vëllëzërve, z.Arben e z.Shkëlqim Riza Brameta

Cmimi fillestar me të cilin hapet ankandi do të jetë 54150000 lek.

Cmimi mund të llogaritet edhe në euro sipas kursit të këmbimit dtor.

Oferuesit duhet të kenë depozituar në llogarinë e zyrës përbarimore 10% të cmimit fillestar.

Adresa: L. 2, prapa Prokurorisë së Rrethit Durrës. Tel/Fax: 052-22-6000
E-mail: best.2010@perbarues.al, web: www.perbarues.al

Shitje me Ankand të Pare nga Studio Perbarimore L.D.C

"Apartment", me sip. 69.2 m², Nr pasurie 10/158+2-1, të ndodhur në Zonen Kadastrale Nr. 8631, Vol. 9, Faqe 00, me adresë Lagja Skenderbeg, Shk. 2, Kati 1, Ap. 1. Prona është e regjistruar pranë Z.V.R.P.P Lezhe, në emër të Luzim Kos Beqiri . Cmimi fillestar për shitje është 3.100.000 Leke.

Data e shpalljes 05.07.2018

Data e shpallimit 31.07.2018 deri në orën 16.00

Ankandi zhvillohet në ambientet e Studios Perbarimore L.D.C me adresë Rruga "Myslym Shyri" Vila 8/1, kati 1 Tiranë.

NJOFTIM ANKANDI

Shoqëria përbarimore "BAILIFF SERVICE E.HOXHA" shpk njofton shpalljen e ankandit të lli-të, për shitjen e pasurive të llojit:

- Arë, me sip. 1.400 m², zK 3235, ndodhur në Rrogozhinë Fshati Bishit i Zhurit, në pronësi të z.Ernold Luan Meke. Ankandi i pasurisë filton me cmimin fillestar në vlerën 564.480 (pesëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e katëqind e tetëdhjetë) Lekë.
- Arë, me sip. 1.485 m², zK 3235, ndodhur në Rrogozhinë Fshati Bishit i Zhurit, në pronësi të z.Ernold Luan Meke. Ankandi i pasurisë filton me cmimin fillestar në vlerën 598.752 (pesëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e shtatëdhjetë e pesëdhjetë e dy) Lekë.

Ankandi do të zhvillohet më datë 24.07.2018, ora 16:00, pranë zyrës së Shoqërisë Përbarimore "BAILIFF SERVICE E.HOXHA" shpk, në adresën Rruga "Vasha Pas" Pallati 13/1, Ap.1, Tiranë, nr.telefon 0682029920, email: givnith@hotmail.com.



I gjenden 30 mijë euro në makinë, arrestohet në flagrancë 37-vjeçari

FIER - Një 37-vjeçar është arrestuar nga policia e Fierit, pasi nuk iu bind urdhrorit për të ndaluar në një pikë kontrolli të ngritur nga blutë. Mësohet se të premtën, në lagjen "1 Maji" të këtij qyteti, 37-vjeçari me inicialet K.B. ishte duke drejtuar një mjet tip "Benz" kur kundërshtoi të ndalonte. Gjatë kontrollit të ushtruar në makinë, iu gjetën e sekuestruan 30450 euro, për të cilat nuk ka dhënë shpjegim për origjinën e tyre. 37-vjeçari akuzohet për veprat penale "Pastrimi i produkteve të veprës penale" dhe "Mosbindja ndaj urdhrorit të punonjësit të policisë së rendit publik".



Shpërthen automjeti në lagjen "Çole", s'ka persona të lënduar

VLORE - Tronditen banorët e lagjes "Çole" në Vlorë. Një automjet ka shpërthyer rreth orës 07:20 pranë një blloku pallatesh, disa minuta pasi pronari e kishte parkuar. Mësohet se makina i përket shtetasit Agim Islamaj, i cili fatmirësisht nuk është lënduar. Ndërkaq, policia është duke hetuar në dy pista, atë të shpërthimit të një sasive lënde plasëse ose ajo e rrjedhjes së gazit nga mjeti. Do të jenë ekspertët, ata që do të përcaktojnë saktë se çfarë e ka shkakton këte shpërthim të fuqishëm që shkaktoi panik te banorët e kësaj lagjeje.

Zbulohet furnizuesi në Shkodër, kryente aktivitetet të paligjshëm

AKU bllokoi 180 kg djathë me niseshte në tregun agro-ushqimor në Tiranë

TIRANË

Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU) ka bllokuar në tregun agro-ushqimor në Tiranë, rreth 180 kg produkt djathi, i cili rezultoi që në përbërje të tij kishte niseshte. Sipas AKU-së, nga inspektimet u konstatua që subjekti me Nipt L52026101D ishte furnizuar sipas një fature të thjeshtë tatimore Nr.2 datë 15.7.2018, nga subjekti Alfred Hila në Shkodër me Nipt K46823021D. Nisur nga ky kontroll, DRAKU Shkodër nisi menjëherë inspektimin në subjektin e lartpërmendur, nga ku konstatoi që subjekti, me Nipt K46823021D kryente veprimtari në kundërshtim me ligjin, pasi nuk zotëronte asnjë dokumentacion shpjegues për gjurmueshmërinë e produkteve. Sipas ligjit në fuqi, çdo subjekt ka detyrim ligjor për të pasur të dhëna të plota e dokumentuara për lëndën e parë të furnizuar dhe për çdo furnizim për të tretë, me produktin përfundimtar të kryer. Men-



jëherë nga trupa e inspektorëve të AKU-së Shkodër u mor masë administrative ndaj këtij subjekti si dhe u vendos masa e bllokimit të produktit djathë të falsifikuar, i cili sipas procedurës do të asgjësohet. AKU gjykon që është e dukshme kryerja

e veprës penale të mashtrimit, parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal dhe këtë rast do e depozitojë me shkrësë në prokurori, në kuadër të bashkëpunimit operacional. Ndërkaq, ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural garanton të gjithë konsumatorët që do të vazhdojë të jetë

vigilente, duke forcuar dhe vënë në lëvizje të gjithë mekanizmat dhe instrumentet e duhura institucionale, me qëllim garantimin dhe fuqizimin e sistemit të gjurmueshmërisë dhe sigurisë ushqimore.

MASAT

Menjëherë nga trupa e inspektorëve të AKU-së Shkodër u mor masë administrative ndaj subjektit furnizues Alfred Hila, si dhe u vendos masa e bllokimit të produktit djathë të falsifikuar, i cili sipas procedurës do të asgjësohet.



Mbytet 18-vjeçari në Gjirin e Lalzit

Hyri në det për të shpëtuar të fejuarën, mbytet i riu në Velipojë

SHKODËR/DURRËS - Dy persona kanë humbur dje jetën në plazhin e Shkodrës dhe të Durrësit. Viktima e parë u shënua në plazhin e Vilunit, në Velipojë. Sipas policisë lokale, 29-vjeçari Elvin Palaj nga fshati Shirq ka hyrë në det që të shpëtonte të fejuarën e tij, e cila rrezikohet të mbytej nga dallgët, por është mbytur vetë. Mësohet se edhe pse të riut i është dhënë ndihma e parë nga personeli mjekësor i plazhit Velipojë, ai nuk ka mbijetuar. Fatmirësisht partnerja e tij është shpëtuar dhe ndodhet jashtë rrezikut për jetën. Ky është rasti i dytë që mbytet një pushues në plazhin e Velipojës për këtë sezon. Mësohet se 29-vjeçari është mbytur në zonën e sigurisë, pasi dhe deti ka qenë i trazuar dhe me dallgë. Në plazhin e Velipojës vijon të jetë problem mungesa e rojeve bregdetare. Kullat e vrojtimit në të gjithë gjatësinë e vijës bregdetare të këtij plazhi vijojnë të jenë bosh. Ndërsa, viktimat tjetër u shënua pasditen e djeshme rreth orës 17:00, në Gjirin e Lalzit në Durrës. Bëhet fjalë për 18-vjeçarin Fatjon Alixheja nga Tirana. Adoleshenti u nxor nga uji në gjendje të rëndë nga pushuesit dhe u dërgua urgjentisht në spital, por nuk mundi që të mbijetonte, pavarësisht ndërhyrjes së mjekëve, pasi parametrat jetësorë ishin shumë të dobët. Mësohet se Alixheja kishte shkuar me familjen për të kaluar fundjavën në Gjirin e Lalzit, por nuk është kthyer më i gjallë. Dy viktimat e ditës së djeshme e çuan në 11 numrin e viktimave në të gjitha plazhet e vendit gjatë këtij sezoni.



INSTITUTE OF STATISTICS OF ALBANIA TENDER NOTIFICATION

Institute of Statistics of Albania intends to award a contract for Bid 2: "Training centre equipment, AC and fire protection"

- Lot 2: Fire Detection System;
- Lot 3: Projector;
- Lot 4: HDD, TV, WebKonf,

in Tirana, Albania, with financial assistance from Sweden, represented by the Swedish International Development Cooperation Agency (Sida) under the project: Direct funding for procurement of IT-equipment and establishing a training centre, with Sida contribution nr: 55020289.

The tender dossier is available at <http://www.instat.gov.al/al/rreth-nesh/procedura-prokurimi/>: from **July 11, 2018**.

The deadline for submission of tenders is: **July 26, 2018, time 10:00 hrs**, at Institute of Statistics of Albania, Blv. "Zhan D'Ark", No. 3, Tirana, Albania.

Possible additional information or clarifications/questions shall be published on the <http://www.instat.gov.al/al/rreth-nesh/procedura-prokurimi/>.

Tenderers may request clarification on any of the documents of the Tender up to the date of submission of offers.



INSTITUTI I STATISTIKAVE NJOFITIM TENDERI



Në kuadër të projektit: "Financim direkt për prokurimin e pajisjeve të IT-së dhe ngritjen e qendrës së trajnimit, "Sida contribution nr: 55020289", financuar nga qeveria Suedeze, e përfaqësuar nga Agjensia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar (Sida), Instituti i Statistikave (INSTAT), Tiranë, do të zhvillojë procedurën e prokurimit me objekt: *Bid 2: "Pajisje për Qendrën e trajnimit, AC and system mbrojtje nga zjarri"*:

- Lot 2: Fire Detection System;
- Lot 3: Projector;
- Lot 4: HDD, TV, WebKonf

Dokumentat e tenderit mund ti gjeni në adresën: <http://www.instat.gov.al/al/rreth-nesh/procedura-prokurimi/>: nga data **11.07.2018**.

Afati i fundit i dorëzimit të ofertave është: **26.07.2018, ora 10:00**, në adresën: Instituti i Statistikave, Blv. "Zhan D'Ark", Nr. 3, Tirana.

Informacionet shtesë ose sqarime/pyetje, do të publikohen në: <http://www.instat.gov.al/al/rreth-nesh/procedura-prokurimi/>;

Kërkesa për sqarime mund të dorëzohen pranë Autoritetit Kontraktor, deri në ditën e fundit për dorëzimin e ofertave.

Table with 4 columns: Name, Address, Phone Number, and Contact Information. Rows include names like Memaliaj, Devoll, and various locations with their respective details.

Table with multiple columns listing names, locations, and dates. Includes entries for various regions like Tiranë, Pogradec, Durrës, and Rogozhinë. The table is organized in a grid-like structure with names and associated information.

Diplomatja: Kemi punuar shumë fort në luftën kundër kanabisit, por njerëzit duan mundësi

Vlahutin në Theth: Qeveria e vendorët duhet të krijojnë mundësi zhvillimi

Ambasadorja e Bashkimit Europian takon banorët: Çfarë duam

Ambasadorja e Bashkimit Europian, Romana Vlahutin, i bën thirrje qeverisë e pushtetit vendor që të krijojnë mundësi zhvillimi në zonën e Thethit. Konkretisht kërkon zgjidhjen urgjente të çështjes së pronës, rrugës dhe energjisë, si tri problematikat që pengojnë zhvillimin e turizmit. Gjatë një vizite në Theth, ambasadorja pati një takim për rreth 90 minuta me banorët e zonës turistike, ku u njoh me problematikat kryesore që pengojnë zhvillimin. "Roli i shtetit është thelbësor, këtë diskutuam edhe me banorët. Kryesorja dhe gjëja e parë që duhet zgjidhur, pasi ka mjaft sensitet është çështja e pronësise. Që në hapat e parë kur parlamenti miratoi vite më parë ligjin 7501, banorët këtu ishin kundër dhe refuzuan ta zbatojnë. Kjo, pasi ata i dinë kufijtë e tokave të të parëve, pra e kanë të qartë kush, si dhe me kë janë fqinj. Është emergjente kjo zgjidhje, sepse ata nuk mund të përfitojnë nga asnjë grant i BE-së, si psh., fondet IPARD. Por kjo është e rëndësishme edhe për investitorët që duan të vijnë këtu, pasi pa certifikatë pronësie nuk mund të bësh asgjë", tha Vlahutin.



tin. Sipas saj, po kaq kryesore në ndërhyrje është dhe infrastruktura. "Nga ana tjetër, infrastruktura është kryesore. Për 8 muaj

rruga është e pakalueshme, pasi bllokohet nga dëbora, e 4 muaj të tjerë të duhet një makinë e mirë të vish, pasi është

shumë e amortizuar. Energjia elektrike është gjithashtu problem, rrjeti i amortizuar dhe luhatjet e tensionit. Voltazhi i ulët prish

ROMANA VLAHUTIN

"Roli i shtetit është thelbësor, këtë diskutuam edhe me banorët. Kryesorja dhe gjëja e parë që duhet zgjidhur, pasi ka mjaft sensitet është çështja e pronësise. Që në hapat e parë kur parlamenti miratoi vite më parë ligjin 7501, banorët këtu ishin kundër dhe refuzuan ta zbatojnë. Kjo, pasi ata i dinë kufijtë e tokave të të parëve, pra e kanë të qartë kush, si dhe me kë janë fqinj. Është emergjente kjo zgjidhje, sepse ata nuk mund të përfitojnë nga asnjë grant i BE-së, si psh., fondet IPARD", tha Vlahutin.

hapësirë e të ruajnde tradicionale, atë që kanë trashëguar e që është thesar i zonës. Pra, nevojitet një ndihmë sa më parë. Qeveria, pushteti vendor duhet të krijojnë mundësi zhvillimi", shton ambasadorja e BE. Nga Thethi, ajo foli edhe për situatën e kanabisit në vend për të cilën diplomatja u shpreh: "Kemi punuar shumë fort dhe të thuash shumë fort, është sërish të mos e theksosh sa duhet luftën kundër kultivimit të kanabisit. Kemi rezultate pozitive. Kolegët tanë italianë po monitorojnë situatën për vazhdimësinë. Nga ana tjetër më duhet të ritheksoj se njerëzve u duhet dhënë mundësia të jetojnë këtu, pasi zona ka kapacitete të ofrojë turizëm gjithëvjetor. Kjo i ndihmon ata të ndërtojnë atë që kanë", - përfundoi Vlahutin.

pajisjet, por së dyti pengon biznesin të zhvillohet siç duhet. Njerëzit këtu kanë ide të qarta si duan të punojnë, ta zhvillojnë këtë

Mbahet në Tushemisht festa e teto Ollgës, mbledh qindra turistë

Klosi: Viti i kthesës së turizmit festiv

Personazhi i njohur dhe shumë i dashur i filmit shqiptar, xhiruar në Tushemisht të Pogradecit, i dha jo vetëm famën fshatit turistik, por tashmë i dha edhe emrin i festës lokale. Për herë të parë në Tushemisht u mbajt për tri net rresht festa e teto Ollgës. Turistëve iu ofruan produkte karakteristike të zonës, punime artizanale dhe prodhime kulinarie tradicionale si petkat. Sheshi i Tushemishtit, ju dha një tjetër alternative pushuesve të shumtë për të shijuar bashkë me natyrën e bukur të zonës, edhe prodhimin e saj tipik. Ministri Klosi, i pranishëm në këtë festë deklaroi se ky vit shënoi kthesën e madhe të turizmit shqiptar: vlerën e shtuar të produktit karakteristik shqiptar. Pas festës së teto Ollgës në

Shumë breza shqiptarësh jemi rritur me figurën e teto Ollgës dhe mitin e atij fshatit shumë të bukur, që ofron mikpritje, traditë, festë, dashuri, ofron pastërti. Duhet të gjejmë magjinë, jo vetëm te teto Ollga dhe Tushemishti, por të gjejmë ofertën e zejtarëve", u shpreh ministri Klosi.



Pogradec, do të organizohet edhe festa e Koranit dhe Belushkës. "Kemi thënë shpesh që vera këtë vit vjen e mbushur me ak-

tivitete dhe kur e thamë këtë para pak muajsh, shumë nuk na besuan. Organizimi i një aktiviteti të thjeshtë, por që syn-

FESTA LOKALE

Për herë të parë në Tushemisht u mbajt për tri net rresht festa e teto Ollgës. Turistëve iu ofruan produkte karakteristike të zonës, punime artizanale dhe prodhime kulinarie tradicionale si petkat. Sheshi i Tushemishtit, ju dha një tjetër alternative pushuesve të shumtë për të shijuar bashkë me natyrën e bukur të zonës, edhe prodhimin e saj

on të kthehet në një traditë. Në të gjithë zonën turistike janë organizuar festa si kjo e teto Ollgës në Tushemisht. Shumë breza shqiptarësh jemi

riritur me figurën e teto Ollgës dhe mitin e atij fshatit shumë të bukur, që ofron mikpritje, traditë, festë, dashuri, ofron pastërti. Duhet të gjejmë magjinë, jo vetëm te teto Ollga dhe Tushemishti, por të gjejmë ofertën e zejtarëve", u shpreh ministri Klosi. Kryetari i bashkisë, Kapri u shpreh: "I jemi përshtatur historisë së këtij vendi. Është vërtet një festë që vërtet i takon fshatit Tushemisht. Uroj ta kthejmë në festë të traditës", ndërsa për Shalsin, kjo festë do të popullarizohet: "Hapim siparin e festës së Ollgës. Mbajeni mend mirë këtë ditë si do të jetë 2-4 vjet më pas. Lajm të mirë do t'ju jap se festa e teto Ollgës në dy vitet e ardhshme do e gjejë Tushemishtin dhe Drilonim në një zonë nga më të bukurat s Shqipërisë. Shumë shpejt do të shihni një kantier pune në zonën e Drilonit dhe Tushemishtit".



MJEKU POPULLOR



Ylli Merja:
Dy receta
për të shëruar
artritin

KESHILLA



Alergjitë,
llojet, shkaqet
dhe simptomat
Si ta parandaloni
sëmundjen

Arqile Gjikondi:

◆ Shenjat e
kësaj sëmundjeje
dhe mënyrat
se si ta trajtojmë
deri në fund



Katër në 5 femra preken nga infeksioni urinar

Mjeku nefrolog: Më problematike
janë kur shoqërohen edhe
me infeksione gjenitale

Shenjat e kësaj sëmundjeje dhe mënyrat se si ta trajtojmë deri në fund

Arqile Gjirkondi:

Katër në 5 femra preken nga infeksioni urinar

Mjeku nefrolog: Më problematike janë kur shoqërohen edhe me infeksione gjenitale



Mjeku nefrolog Arqile Gjirkondi

Voltiza Duro

Katër në 5 femra preken nga infeksioni urinar të paktën një herë në jetën e tyre, ndërsa rreth 30% e tyre shfaqin probleme të përsëritura në periudha të ndryshme apo vazhdimisht. Në një intervistë për suplementin "Life Pages" në "Gazeta Shqiptare", mjeku nefrolog internist, Arqile Gjirkondi tregon se shpeshherë këto lloj infeksionesh urinare janë të lidhura me ato gjenitale e më tej shton se femrat seksualisht aktive janë më të predispozuar për t'u prekur.

Sa të prekura janë femrat nga infeksionet urinare?

Në çdo 5 femra, 4 prej tyre provojnë një infeksion urinar të paktën 1 herë në jetën e tyre. Ndërkohe 20% -30% e femrave kane infeksione urinare të përsëritura, në periudha të ndryshme, ose vazhdimisht.

A janë të lidhura infeksionet urinare me ato gjenitale?

Është gjë e rrallë që një femër aktive të jetë e sëmurë vetëm me infeksion urinar,

përgjithësisht infeksionet urinare janë të kombinuara me infeksione gjenitale të jashtme ose të brendshme, si dhe me probleme të zorrës së trashë dhe anale. Është pikërisht për këtë arsye që në praktikën e përditshme, unë vazhdimisht kërkoj elemente të infeksioneve gjenitale, ose të zor-

rës së trashë, si dhe të partnerit. Vetëm mjekimi i kombinuar i të gjitha organeve të infektuara siguron një shërim të qëndrueshëm dhe efektiv të sistemit urinar femëror.

Cilat janë kategoritë më të predispozuar për t'u prekur nga sëmundja?

Më të predispozuar janë femrat seksualisht aktive, sidomos në ditët


dhe javët e para të fillimit të aktivitetit seksual me një partner

të ri, (aq më të theksuara janë kur kanë aktivitet me më shumë se një partner). Ato kanë probleme të jashtëqitjes (kapsllëk, diarre, hemorroide etj.), profesionet me qëndrime të gjata ulur në karriqe, shtatzënia, plazhi, pishinat, përdorimi i tepruar i dezinfektantëve vaginale, abortet, femrat që përdorin pilula kundër shtatzënisë, ose që përdorin pajisje brenda qafës së mitrës (spirale) kundër shtatzënisë. Ndryshimi i shpeshtë i partnereve seksualë e favorizon tej mase infeksionin urinar, si dhe infeksionin gjental sëmundjet e përgjithshme si diabeti, dobësimi i muskulaturës vaginale (për zonjat që kanë lindur shumë fëmijë dhe të moshuarat sidomos). Reumatizma etj., etj. favorizojnë mjaft infeksionet urinare rezistente, kronike.

Sa ndikon prania e gurëve në veshka në zhvillimin e infeksioneve urinare?

Një faktor me rëndësi në shfaqjen e infeksioneve urinare të përsëritura është edhe prania e gurëve në veshka, apo në kanalët e urinës, në vezikën urinare. Nuk ka rëndësi përmasa e gurit, por fakti se sa i thërrmueshëm

SISTEMI URINAR



është ai, çfarë sasia kristalesh lëshon përgjatë rrugëve urinare. Po ashtu, është me mjaft rëndësi të kihet parasysh edhe prania e deformimeve të vezikës urinare (të lindura, apo të fituara, pas lindjeve të përsëritura. Pas operacioneve të ndryshme. Mjaft problem është invaliditeti, që japin këto sëmundje tek aftësitë e femrës për punë, aktivitetet shoqëror dhe seksual për mirëqenien trupore dhe mendore. Theksohen mjaft neurozat, lodhja e përgjithshme pa shkak të dukshëm, djerse etj. Afërsia anatomike e kanalit dhe vezikës urinare me organet gjenitale, (vaginë, mitër, tuba dhe vezore) si dhe me zonën e anusit e bën të pashmangshme sëmundjen ose irritimin e njëherëshëm të organeve urinare dhe organeve gjenitale të femrës, gjë që e vështirëson disi diagnozën dhe mjekimin e saktë të sëmundjeve të poshtme femërore.

Cilat janë disa prej simptomave kryesore të sëmundjes?

Disa prej simptomave kryesore që shfaqen te pacientet e prekur nga infeksionet urinare janë: urinim i shpeshtë (urinimi normal është çdo 2 orë), djegie, dhimbje, shpeshherë të padurueshme, që kërkojnë mjekim urgjent; urinim me gjak i pastër, ose si të shpëlarat e mishit, ose me pelte (koagula), erë e rëndë e urinës; ndjenje e moszbrazjes së plotë, ndjenja sikur do të të dalë diçka poshtë në kanal të vaginës. Gjithashtu, pacientët mund të kenë edhe urinim natën, qoftë edhe një herë, rrjedhje të urinës me pika, në sforcime të vogla fizike apo edhe ndjesi të urinimit menjëherë pas kafes.

Ku shfaqen dhimbjet më të zakonshme?

Dhimbjet më të zakonshme janë në mes, në fundin e barkut, ose në njërin anë të fundit të barkut. Por mund të shfaqen edhe dhimbje në pjesën e brendshme të kanalit vaginal që shtohen në pozicionin në këmbë ose ulur, ose gjatë kontaktit seksual, ose ndjenje e diskomfortit



të vazhdueshëm në fund të barkut, e papërcaktuar. Shpeshherë këto simptoma të organeve urinare paraprihen nga simptoma të organeve gjenitale.

Cilat janë disa prej simptomave të organeve gjenitale?

Këto simptoma janë: sekrecione vaginale të shtuara, të ndryshme nga sekrecionet normale, me ngjyrë të bardhë, verdhë, jeshile, kafe, të kuqe, me copa, ose të trasha si gjizë. Shpesh me erë të rëndë si peshk, djathë i prishur etj., që shoqërohen edhe me dhimbje mesi, rëndim në fund të barkut ose anash tij, dhimbje gjatë kontaktit seksual, çregullim të menstruacioneve, skuqje, kruajtje të buzëve të vaginës ose vështirësi për të mbetur shtatzënë etj.

Mund të përmendni disa prej ekzaminimeve që duhet të kryejnë pacientët e prekur nga infeksionet urinare?

Analiza e urinës zbulon leukocite, mikrobe (baktere), që tregojnë për një infektim të kampionit të urinës nga vagina ose një

infeksion mjaft të rëndë urinar, me mikrobe të gjalla. Ndërsa eko e aparatit urinar është e domosdoshme në rastet e infeksioneve të zgjatura, mbi 5 ditë, me temperaturë, ethe të përsëritura. Ekzaminimi me eko ka rëndësi për përjashtimin e shkaqeve të deformimit të strukturës së veshkave, ose praninë e gurëve, tumorëve, zgjerimeve të kanaleve, gjendjen e mitrës, tubave dhe vezoreve, gjendjen e vezikës urinare etj., etj.



Urokultura është analizë që shërben për gjetjen e llojit të mikrobit që shkakton infeksionin. E nevojshme në rastet e infeksioneve të rënda, të zgjatura dhe të përsëritura. Nga eksperiencia ime, mendoj se duhet të kihet parasysh që në rastet kur gjejmë një mikrob, përgjithësisht ka edhe mikrobe të tjera shoqëruese, të cilët per momentin nuk shfaqen në kulturë, por që janë përgjegjëse për vazhdimin dhe

gjenitale, sidomos infeksionet gjenitale që shkaktohen nga Klamidia, një mikrob mjaft i përhapur, që gjendet me mjaft vështirësi në analiza (janë mjaft të kushtueshme) dhe që lë shumë pasojë negative në sistemin riprodhues të femrës dhe mashkullit (sterilitet, ngjitje të tubave, barrë jashtë mitrës, etj., ndërsa te mashkulli jep sterilitet dhe prostatit kronik, mjaft rezistent, dhimbje, impotencë etj., etj., që trajtohen në një artikull të veçantë, që kam bërë për meshkujt e rinj). Në vizitat rutinë është e vështirë të gesh Klamidias, sidomos te femrat që duan të bëjnë fëmijë) me kusht që të mjekohet edhe partneri.

rishfaqjen e sëmundjes. Për këtë arsye, unë përgjithësisht jap disa lloje antibiotikësh të kombinuar, me qëllim që të përfshihen sa më shumë mikrobe në trajtim.

Sa kohë nevojitet për trajtimin e një infeksioni urinar?

Përgjithësisht, infeksionet e thjeshta urinare vetëshërohen brenda 3-5 ditëve edhe pa mjekim, por gjithsesi lënë pas një ulje rezistencë të kanaleve të urinës. Në këto raste, një mjekim i thjeshtë me antibiotikë, prej 3-5 ditësh është i mjaftueshëm, me kusht ripërsëritjen e analizave të urinës pas 10-15 ditëve. Në rastet e infeksioneve të përsëritura kërkohet mjekim më i gjatë deri në 2-3 javë, me mundësinë e përsëritjes së mjekimit me antibiotike çdo muaj nga 1 javë për 2-4 muaj. Më problematike janë infeksionet urinare që shoqërohen me infeksione

Në përgjithësi, me një mjekim të përshtatshëm, por sidomos në kohën e duhur, këto infeksione urogenitale që përmendëm mjekohen mirë dhe pa pasojë, por në të kundërt japin mjaft pasojë invalidizuese për femrën dhe partnerin e saj. Problemi kryesor është fakti që femrat i durojnë shqetësimet që përmendëm më lart dhe përgjithësisht e neglizhojnë vizitën te mjeku specialist, shpesh mjaftohen me përdorimin e çajrave të ndryshëm bimorë, që gjithsesi nuk kanë aq fuqi shëruese sa antibiotikët, (thjesht janë shumë të mirë në mirëmbajtjen e infeksioneve, në mbrojtjen, por jo në luftimin e tyre, sidomos në fazën akute).



Artriti reumatoid dhe herniet janë dy nga problemet më të shpeshta që shfaqen me kalimin e moshës. Shkaqet janë të shumta, por trajtimi me medikamente nuk është gjithnjë efikas. Mjeku popullor Ylli Merja tregon se cili është trajtimi më i mirë që mund të bëni për problemet e artritit reumatoid, herniet dhe osteoporozën, si një kombinim me çajrave me bimë mjekësore, vajrave esenciale dhe farave të senapit.

Shkaqet

Sipas tij, shkaqet që ndikojnë në artritin reumatoid, ose poliartritin janë dy: Së pari është moshë funksionimi i mirë i qarkullimit të gjakut, që ka shkaqet e veta, siç janë trashësia e gjakut, rritja e kolesterolit, apo edhe depozitimi i acidit urik në kyçe, i cili shfaqet me dhimbje, ënjtje dhe tharje të lëngjeve.

"Lëngu sinovial që ndodhet midis kyçeve, midis kërcëve nga pesha, nga vitet, nga lodhja, nga shtypja fillon të largohet dhe kockat afrohen aq shumë sa që edhe ato fërkohen me njëra-tjetër dhe japin dhimbje të forta. Duke e studiuar mirë këtë defekt patologjik në organizëm, kemi arritur që së pari t'i shmangim këto problem duke përdorur disa çajra", - thotë Merja. Sipas tij, trajtimi është i përbërë nga një recetë që përshkruhet me kombinimin e disa bimëve mjekësore dhe përdorimi i disa vajrave në një recetë të dytë. "Në parimin tonë jemi udhëhequr nga motoja: parimi bën fuqinë. Nuk përdorim vetëm një bimë, por duke ditur vetitë e përafërta të bimëve mjekësore, kemi kompozuar këtë çaj, që së pari redukton acidin urik të ngritur, i cili jep edhe probleme në veshka dhe së dyti të sjell një funksionim të mirë të qarkullimit të gjakut në arterie dhe vena. Së treti, aty ku gjaku qarkullon lirshëm, shkojnë edhe lëndët ushqyese dhe oksigjeni. Zgjidhja e problemit të artritit reumatoid mendojmë që është e dukshme brenda një periudhe kohe shumë të shkurtër", - thotë Merja.

Rezultatet

Përdoruesit e kësaj recete, sipas Meres, i ndien me të vërtetë frytet e një pune studimore shumë të arrirë, vetëm brenda dy ditësh. "Është më i mirë se çdo medikament tjetër farmaceutik. Unë do të këshilloja përdorimin e një çaji, që është i kompozuar. Ai përmban çaj antikolesterol, disa gjethe kundër reumatizmit, gjethe e urthit, gjethe e hithrës, lulen e tërfillit të kuq të malit dhe gjethe e bishtit të kalit. Dhe së dyti, është përdorimi i një vaji bimor që ne e kemi quajtur vaj për artritin dhe hernien", - thotë mjeku popullor. Ky vaj esencial dhe çajrat janë marrë kryesisht nga farat e sinapit, nga ekstraktimi i gjetheve të pishës, dafinës, bredhit e me radhë.

Receta e çajit

Çaji duhet të përdoret 3 herë në ditë, duke zierë në 2 litra ujë,



Këshillat e mjekut popullor për trajtimin e sëmundjeve me bimëve mjekësore

Ylli Merja: Dy recetat për të shëruar artritin

Shkaqet dhe mundësitë e kurimit edhe për hernien e reumatizmit



Mjeku popullor Ylli Merja

një përzjerje me 5-6 lugë gjellë çaj për kolesterolin, një dorë me hithra, disa gjethe urthi, një dorë me gjethe të bishtit të kalit dhe pak dëllinjë, ose trëndafil të egër. "Këto përdoren në varësi individuale për çdo përdorues. Nëse ka obezitet, fusim në këtë përzjerje edhe pak gjethe mëshkteke. Nëse ka problematika me luhajtjen e tensionit, atëherë shtojmë më shumë çajin e kolesterolit. Nëse ka një aritmi zemre që shoqërohet edhe me vështirësi në ecje, atëherë i shtojmë edhe bimë të tjera", - thotë Merja. Sipas tij, do të ishte shumë e suksesshme biseda

me pacientin dhe ekzaminimet mjekësore që mund të ketë bërë. "Nëse kemi një grafi për kockat është mirë të dimë se ku është problemi më i madh i tharjes së lëngut sinovial, nëse kemi analizat e gjakut, mund të shohim a ka acid urik të ngritur, apo kolesterol. Biseda me pacientin është tamam sikur të të qepin një kostum sipas përmasave të trupit tënd", - shprehet ai.

Ndryshimet mes gjinjeve

Në përgjithësi te femrat ka një porozitet më të madh të kockës. "Ne i shtojmë tërfillin këtij çaji kur bëhet fjalë për të ka kripëra minerale për të forcuar kockën, ose i shtojmë vaj bajameje dhe lajthi,

për të forcuar kockën, ndërsa për meshkujt shtojmë diçka tjetër për t'i dhënë më shumë forcë burrërore, shtojmë rrënjë hithre dhe gjethe hithre, ndërsa një femre mund t'i japim farat e hithrës, ose mund të shtojmë dozat e tërfillit të kuq, për të forcuar kockën sidomos në pjesën e kokës së femurit, kur kjo kockë bëhet shumë poroze", - shpjegon Merja. Madje, duke parë edhe grafitë, sidomos te njerëzit që janë më të moshuar, të kenë kujdes në ato pika të kockës, që të mos e dëmtojnë dhe të mos thyhet. "Ky trajtim ka dhënë rezultat, bashkë edhe me një dietë ushqimore të duhur. Kemi përgatitur një ushqim për mëngjesin me bajame, thekër ose edhe çajrat e më-

sipërme dhe kemi vënë re që pas 4-5 muajsh, disa pacientë që kanë qenë në kufirin e osteoperisë, janë ngjitur në brezin normal. Ose kanë ardhur nga kufiri i osteoporozës në kufirin normal të kockës, që duket duke i krahasuar dy grafitë e kockave", - thotë Merja.

Trajtimi me senap

Për disa persona që ndoshta nuk kanë mundësi të gjejnë këtë trajtim, është edhe një tjetër alternativë sipas mjekut popullor, që mund t'u shërbejë për të lehtësuar dhimbjet. "Nëse janë nga zona e Klosit, apo Burrelit dhe nuk kanë mundësi që të marrin këto produkte ata, në kushte shtëpie, mund të marrin farën e senapit të zi, që të djeg nëse e shtyp me dhëmbë dhe të bëjnë një pastë për të lyer zonat e ndryshme. Ai rritet edhe në zonën e Lushnjes nëpër grurë, edhe në zonën e Burrelit. Mund ta shtypni pak që ta bëni si miell. Lyeini pjesën e trupit që dhemb me pak vaj ulliri dhe hidhni miellin e senapit. Lërimi për 2-3 orë dhe menjëherë ajo bën efektin e saj. Pastaj hiqeni atë dhe mund ta shihni gjurmët që ka lënë", - shprehet Merja. Kështu, duke eliminuar medikamentet që shpesh japin edhe efekte anësore, këto probleme të artritit reumatoid, hernieve apo osteoporozës mund të gjejnë shërim, thjesht duke kombinuar disa bimë mjekësore apo edhe vajra esenciale, për një trajtim sa më natyral të shëndetit.

Këshilla

Alergjia është një reagim armiqësor i sistemit imun ndaj një substance që normalisht do të konsiderohej e padëmshme. Reaksionet alergjike shkaktohen nga ekspozimi ndaj alergjenëve. Një alergjen është një proteinë që organizmi e vlerëson si të huaj dhe të rrezikshme. Alergenët mund të jenë ushqime të veçanta, toksina të mjedisit, poleni i luleve dhe pemëve, myku, morri i bimëve, zemërimi shtazor dhe një morri irrituesish të tjerë. Menjëherë pas ekspozimit ndaj një alergjeni, sistemi imun lëshon antitropa specifike për të shkatërruar këtë alergjen armik, duke angazhuar një seri komplekse veprimesh që përfshijnë një sërë reaksionesh biokimike. Më pas, këto kimikate prodhojnë një inflamacion ose simptoma të tjera të një reagimi alergjik. Reagimet alergjike mund të jenë nga më të lehtat deri te më të rëndat, ku këshilla profesionale mjekësore e menjëhershme bëhet e domosdoshme.

Simptomat

Në simptomat e përbashkëta të reaksioneve alergjike tipike përfshihen vështirësia në frymëmarrje, përflakja, përskuqja e syve, kruajtja dhe lotimi i tyre, teshtima, kollitja, kruarja, sekrecionet e hundëve, muftaja, nxehja e fytyrës, rrethi i errët nën sy, kullimi i hundëve, ënjtja, urtikaria, të vjellat, shtrëngimet e stomakut dhe acarimi i zorrëve apo ënjtja e tyre. Reaksionet më të rënda përfshijnë shtrëngim të kanalave bronkiale (astma), vështirësi në frymëmarrje apo edhe krizë anafilaktike, e cila mund të bëhet vdekjeprurëse nëse nuk trajtohet në kohë. Alergjia mund të rezultojë gjithashtu në stresimin e sistemit të tretjes, në gazrat e zorrëve dhe në mostretjen e ushqimit apo keqtrajtjen e tij. Njerëzit e ndjeshëm mund të ndiejnë edhe pezmatim në gjuhë ose në gojë.

Llojet e alergjeneve që shkaktojnë reagim alergjik

Alergenet e mjedisit, ku përfshihen lëndët kimike, toksinat, myqet, pluhurat e irritues të tjerë në mjedisin tonë, të cilat e bëjnë rrugë të tyre ajrin tonë, shtëpitë tona, ujin dhe ushqimet tona. Alergenet ushqimorë janë zakonisht ushqime të padëmshme, por që shumica e njerëzve nuk i pëlqejnë.

Shkaktarët e zakonshëm të llojeve të ndryshme të alergjive

Shumica e alergjeneve apo shkaktarëve të zakonshëm të alergjive ndeshen në katër kategori kryesore: kontakti, gëlltitja, nuhatja dhe injeksioni. Nëse jeni alergjik,



Alergjia, llojet, shkaqet, simptomat

Ja si ta parandaloni sëmundjen


ju shpeshherë jeni të ndjeshëm ndaj më shumë se një substance.

Alergenët e kontaktit mund të jenë bimë të tilla si dredhka helmuese, lisi dhe valanidhi, bizhuteri, produkte shtëpiake për pastrim, duke përfshirë edhe sapunët dhe detergjentët të tjerë, apo produktet e zburimit të tilla si ato kozmetike dhe ngjyrat e flokëve.

Alergenët e gëlltitjes përfshijnë ushqimet, ilaçet, si dhe metalet e rënda në ujin të pijshëm. Ushqimet më të shumta që shkaktojnë reaksione alergjike janë: gruri, misri, qumështi dhe produktet tij, e bardha e vezës, domatet, soja, gaskat e detit, kikirikët, çokol-

latat, si dhe ngjyrat e ushqimit, aditivët dhe pesticidet. Kurse prej medikamenteve që shkaktojnë reaksione alergjike përmendim as-

pirinën, ilaçet nonsteroidal antiinflamator (NSAID) dhe antibiotikët si Amoxicillin dhe Penicilina.



Alergenët e nuhatjes, ku përfshihen produktet kimike ajrore dhe tymi, tymi i duhanit, inati shtazor, zhgualli i kacabunjve, pluhuri i morrave të bimëve, sporet e mykut, nxjerrjet e makinave dhe kamionëve dhe poleni i bimëve të tilla si bari, pemët dhe barërat e këqija.

Alergenët e injeksioneve, përfshirë këtu pickimin dhe thumbimin e insekteve dhe në disa raste, medikamentet injektuese (duke përfshirë edhe vitaminat sintetike-artificiale të farmacisë).

Shkaqet e alergjive

Në përgjithësi shkaqet kryesore për alergji dhe ndjeshmëri kanë të bëjnë me dietën ushqimore dhe stilin e jetesës dhe këto shkaqe janë: funksioni imun i pabalancuar, funksionet penguese të supozuar, (siç është sindromi i "zorrës që pikon") dhe mbin-

garkesa toksike. Secili prej këtyre shkaqeve në shkallë të ndryshme është përgjegjës për zhvillimin dhe vazhdimin e alergjisë dhe ndjeshmërisë.

Funksioni imun i kompromentuar: Një sistem imun i pabalancuar rrit seriozisht rrezikun e reaksioneve alergjike. Çrregullimi dhe çekuilibrimi i sistemit imun të dikujt shkaktohet nga vaksinimet dhe imunizimet e përsëritura në kohën e fëmijërisë dhe në moshën madhore, nga dëmtimi i florës së shëndetshme për zorrët dhe mbështetja dhe mbështetja tek antibiotikët dhe steroidet (sidomos pilulat kontraceptive për ndalimin e shtatzënisë). Ilaçe të tilla e ngatërojnë organizmin dhe sistemi imun i tij has probleme në dallimin e mikut nga armiku.

Shkaqet e tjera të mosfunksionimit imun janë dobësia e trashëguar, mungesat ushqimore, dietat e përsëritura dhe monotone, kimikatet në ushqim, si pesticidet dhe lëndët ruajtëse, si dhe tharja kronike dhe gjithnjë në rritje e zorrëve (Candidiasis). Dieta mesatare e një pacienti alergjik normalisht përbëhet nga 30 ushqime ose më pak dhe ushqimet që ai ha më shpesh mund të bëhen bazë për intolerancën ushqimore.



DOSSIER

Balli Kombëtar dhe zogistët tani po publikojnë gazeta ambicioze e të shtrenjta, qartazi progjermane. Në 8 botime nuk gjen asnjë referencë antigjermane. Të dyja palët lavdërojnë aleatët se do të bashkëpunojnë me ta pasi të ikin gjermanët...

Ylli Polovina:

Marrëveshja e Mukjes ishte një lojë

Ylli Polovina

Për të kuptuar Mukjen, marrëveshjen e paze të paralizuar të saj, pra 1-2 gushtin 1943, mund të përdoret edhe kryqëzimi i dy "projektorëve" nga pozicione të skajshme. Njëri i ndezur mbi të që prej fillimit të vitit dhe tjetri dritëdhedhës nga ditët mbyllesë të këtij moti. Mes tyre ndodhet një hapësirë prej të paktën tetë muajsh.

Po e nisim vështrimin e kësaj ngjarjeje prej këndit të fundit.

Në librin "Shqipëria dhe të Mëdhenjtë", 2015, i historianit aktual më të spjerruar në njohjen e raporteve tona me amerikanët dhe britanikët, njëkohësisht drejtues departamenti në Institutin e Historisë, prof. dr. Hamit Kaba, ka të botuar në faqet 201-202 një telegram të Gjeneral Brigadier Davies, shefit të të gjitha misioneve ushtarake britanike me vepir në Shqipëri.

Është Dejvisi i famshëm, të cilin Enver Hoxha në librin e tij "Rreziku anglo-amerikan për Shqipërinë", e vizaton si karikaturë, si mosdashës të popullit tonë dhe pothuaj mohues të Luftës Nacionallçirimitare të prirë nga PKSH.

Telegrami me burim Ministrinë e Jashtme Britanike, në arkivin e saj konkretisht në adresën burimore TNA, PO 371/ 37145, f. 103-104, daton 17 dhjetor 1943 dhe i drejtohet "Shtabit të Forcës 133 në lidhje me situatën luftarake në Shqipëri dhe denimin e Këshillit të Regjencës, Ballit Kombëtar dhe zogistëve si bashkëpunëtorë të gjermanëve".

Teksti i plotë është ky:

"1. Tani rekomandoj një ndryshim. Situata e zhvilluar së fundi (e bën) kaq të domosdoshme denoncimin kolektiv dhe me emra të veçantë të Këshillit të Regjencës, si edhe Ballin Kombëtar dhe zogistët.

2. Të gjithë po bashkëpunojnë me gjermanët, të cilët i pajisin me armë në sasi të mëdha, duke i vendosur si roje në rrugët kryesore, si policë qytetesh dhe si drejtues patrullash, duke lënë kështu të lira trupat gjermane.

3. Të gjitha aksionet e fundit luftarake të LNÇ janë zhvilluar kundër trupave të përziera gjermane e të Ballit Kombëtar, të përgatitura e të armaturosa mirë nga gjermanët.

4. Të dy, Balli Kombëtar dhe Abaz Kupi më premtuan mua, se do të luftonin aktivisht kundër gjermanëve, por muajin e fundit ata nuk kanë bërë asnjë aksion të vetëm, ndonëse kanë pasur shumë shanse për t'u rezistuar gjermanëve. Abaz Kupi ka dhënë dorëheqjen nga posti i tij në Këshillin e LNÇ dhe u prish me ta.

5. Të dy, Balli Kombëtar dhe zogistët tani po publikojnë gazeta ambicioze e të shtrenjta, qartazi progjermane. Në 8 botime nuk gjen asnjë referencë antigjermane. Të dyja palët lavdërojnë aleatët se do

të bashkëpunojnë me ta pasi të ikin gjermanët, duke cituar si dëshmi dështimin britanik për të përmendur Këshillin e Regjencës apo ndonjë parti politike. Shembull: Fjala e drejtorit të BBC (British Broadcast Corporation) për Shqipërinë më 28 nëntor.

6. Do të preferoja t'i shpjegoja këto personalisht kur të vij aty, por mund të vonohem dhe nuk ka gjasa që të arrij tek ju përpara mesit të janarit në rastin më të parë.

Mendoj se qëndrimi i Aleatëve duhet të bëhet menjëherë publik, duke treguar se kuizlingët, tradhtarët dhe jo rezistuesit ndaj gjermanëve, do të marrin trajtimin e duhur ndëshkues nga aleatët në kohën e duhur. Shqiptarët e kanë luajtur këtë lojë kuizlinge me suk-



Telegrami i zemëruar i gjeneralit britanik Dejvis: Ballistët dhe zogistët po bashkëpunojnë me gjermanët

PKSH dhe BK nuk kanë dashur asnjëherë të bashkëpunojnë singjerisht, prandaj edhe Mukja që një hile e radhës

ses me turqit, italianët dhe tani me gjermanët. Ata janë të bindur se po bëjnë të njëjtën (lojë) me aleatët. Prandaj rekomandoj një deklaratë të hapur pro LNÇ-it".

Sot kjo gjuhë e gjykimit si e gjeneralit britanik Dejvis prej jo pak bashkëkombësve të shpallur krenarisht si ballistë apo mbretërorë antikomunistë, do të konsiderohet si mendësi tërësisht enverist. Prandaj ajo edhe është mënjëruar jo vetëm prej ndonjë botimi paralel me librin e profesor Kabës (çfarë përmbajnë gjatë Luftës së Dytë Botërore arkivat britanike), por edhe nga mediat më të hapura për të paraqitur opinionet e kundërta.

Duke mos menduar se kjo është patjetër sjellje tipike censure, rezulati gjithsesi është i njëjtë: fshehje

e së vërtetës historike, e asaj që ka ndodhur realisht. Partitë që dje dhe sot përfaqësojnë mjediset të afërta me komunistët apo me ballistët përpiqen ca më shumë sot të largojnë nga kujtesa kombëtare pikat e afërimit në marrëdhëniet mes tyre, të cilat gjatë luftës nuk u kryen vetëm në Mukje. U duhen patjetër armiq, ndryshe nuk funksionon lufta për pushtet.

BALLI KOMBËTAR SI FRONT PA LUFTË

Profesori i paharruar Kristo Frashëri ka qenë përherë i mendimit se programin e vet politik, Dekalogun, Balli Kombëtar e ka shpallur publikisht jo kur njoftoi themelimin, në nëntor 1942, por në marsin e ardhshëm. Sipas tij, atë e botoi "Oshëtimia e Korçës" në numrin 1 të saj, mars 1943. Dekalogu ndodhet në faqen 23.

Historiani Frashëri saktëson se në faqen pasardhëse, 24, të organit të mësipërm, gjenden njëri pas tjetrit emrat e të gjithë anëtarëve të Komitetit Qendror të Ballit: 1. Mithat Frashëri, 2. Fuat Dibra, 3. Faik Quku, 4. Nuredin Vlora, 5. Ali Këlcyra, 6. Hasan Dosti, 7. Kol Tromara.

Gjithnjë sipas profesorit, "Shpallja publikisht e emrave të anëtarëve të Komitetit Qendror tregon se në marsin e vitit 1943 Balli Kombëtar nuk ishte më organizatë klandestine dhe se udhëheqësit e saj ishin të sigurt se nuk do të ndiqeshin nga administrata policore fashiste italiane".

Pra, në një regjim pushtimi diktatorial, antiparlamentar, BK u shndërrua në forcë politike legale. Në fashizëm, si edhe i pamë në komunizëm, sipas rregullit këto qenë struktura satelite me partinë e vetme në pushtet, e cila edhe në Shqipërinë e motit 1943, me pavarësimin territorial të asgjësuar e të bashkëngjitur me shtetin (perandorinë) italiane, ekzistonte: që Partia

FESTIVALI NDËRKOMBËTAR I FILMIT TË SHKURTËR

"LULET PLASTIKE" TË YLLJET ALIÇKËS MARRIN ÇMIM

U mbyll Festivali Ndërkombëtar i filmit të shkurtër në Korçë "Korça Short Film Fest", me drejtor Gledis Bicën. Përgjatë datave 17 deri më 20 korrik u shfaqën gjithsej 40 filma ndërkombëtarë në kategoritë: documentary, fiction dhe animation, ndarë në dy sesione në Teatrin e "Andon Zako Çajupi" dhe Pazarin e Vjetër, Korçë. Ndërkohë të gjithë filmat shqiptarë dhe shqipfolës garuan në garën kombëtare, sipas kategorive të filmave dhe fushave të studimeve si Filmi artistik më i mirë, Filmi Dokumentar më i mirë, Filmi më i mirë i animuar, Regjia më e mirë, Skenari më i mirë. Juria ndërkombëtare e festivalit e përbërë nga Toma Waszarow, regjisor, producent polka nga Bullgaria; Tudor Vintilou, drejtor fotografie, fotograf nga Rumania dhe Anna Oreshkova, asistente regjimore pranë kompanive filmike amerikane "Nu

image" dhe "Ufo" vlerësoi edhe filmat e shfaqur me çmime. Çmimi "Best Student Short Film" shkoi për "FAITH" të Tatiana Fedorovskaya (VKIG Film School/Russia), çmimi "Best Albanian Short Film" shkoi për "Plastic flowers" i Ylljet Aliçkës (Kinostudio Dardan/Albania), çmimi Best Short Fiction shkoi për

"Like A Good Kid" i Arian Vazirdaftari, Iran; çmimi Best Short Documentary shkoi për "Rewind Forward" i Justin Stoneham Zvicër dhe çmimi Best Short Animation shkoi për "Laymun" C.Prowse, H.Quin Britani. Ndërkohë, Juria shpërndau edhe katër çmime speciale si më poshtë: "Earthly People" i Adam Freund Hungari, "Nobody" Elham Torogji Iran; "The Victory of Charity" i Albert Meisl Austri dhe "Public Laundry" Christina Zachariades Portugali.



◀ **Fashiste.** Ajo italiane dhe dega e saj shqiptare.

Referuar për sa më sipër për këdo është e qartë se Balli Kombëtar, kjo organizatë e shpallur nacionaliste, por që po përshtatej për bashkëzistencë paqësore me regjimin e pushtimit, duke qenë pa asnjë emër sekret në udhëheqjen e saj, donte të përcillte mesazhin se e pati paracaktuar prerë kursin e saj politik: atë të mosluftimit kundër pushtuesve.

Në mars 1943 BK që i tillë, me prirje për ta shtyrë betejën me armë më vonë, në një çast të përshtatshëm, por gjithsesi komunistët nuk e interpretuan këtë si kolaboracionizim të rëndë. Siç edhe më parë, në Konferencën e Pezës të shtatorit 1942, patën vepruar nën direktivën e Internacionales Komuniste, këtë herë edhe nën presionin britanik, komunistët stalinistë hynë në dialog me ballistët.

Ose bënë sikur, sepse filluan lojën politike.

Prezandues me doktrinën për një Shqipëri me vetëm një parti dhe sistem shoqëror "diktaturë e proletariatit", ata dëshironin t'i shpëtonin gjyqit të historisë (dhe të aleatëve anglo-amerikanë), se qenë të fajshëm për ndonjë favorizim të pushtuesve si edhe nxitje të ndonjë përplasjeje civile me popullit. Donin tua linin ballistëve këto përgjegjësi dhe mëkatë.

Por, edhe Balli Kombëtar që i taktikës me goja. Shqipëria e ardhshme për ta mund të ishte shumë-partiake, por komunistët stalinistë, proslavë ca më shumë, duhej të paralizoheshin dhe të nxirreshin jashtë ndikimit politik dhe po të që e mundur, edhe jashtë ligjit.

Për ta mbajtur të fshehur këtë lojë me ta hedhur, të dyja palët kryesore, PKSH e BK, jo pak edhe zojistët, kanë tentuar ta fshijnë faktin e madh historik se drejt bashkëpunimit kanë qenë nxitës anglezët dhe jo vullneti i tyre. Britanikët, më shumë se për hir të demokracisë, e kryen këtë veprim jetik sepse synonin që të gozdhonin në trojet e shqiptarëve si edhe në të tërë Ballkanin sa më shumë qara luftarake fashiste, çfarë ua lehtësonte frontin pranë. Misionet ushtarake britanike edhe në Jugosllavi apo Greqi këtë trysni bënë: marrëveshje bashkuese të përkohshme të të gjitha forcave politike vendase, me objektiv të palëkundur goditjen e përhershme, ditën atë, të fashistëve italo-gjermanë.

Ata nuk e mbajtën dot të fshehur se menjëherë pas luftës do t'i shtypnin me dorë të hekur komunistët. Kjo e rriti edhe më shumë domosdoshmërinë e lojës politike prej të gjithëve.

ENVER HOXHA HAP DERËN PËRGJYSMË, POR PËR TIA ZËNË KOKËN BALLIT

Siç edhe u mbajt në terr përmabajta e atij telegrami të gjeneralit Dejvis të 17 dhjetorit 1943, errësira u imponua prej komunistëve dhe ballistëve edhe për një periudhë "pranverë" të raporteve mes tyre. Kurrikush nuk ka folur për të, ca më shumë për ta trajtuar si shembull të mirë. Për një gjysmë shekulli stalinistët shqiptarë qeverisën me antiballizëm. Pas vitit nëntëdhjetë, këta të fundit e konsideronin të dëshëmshëm se kanë shkëmbyer një fjalë të mirë me komunistët.

Por, ja që një qiell me pak re në raportet e tyre ka ekzistuar. Në janar 1943 ka një letër të Partisë Komuniste të Shqipërisë për Komitetin



Qarkor të Korçës. Atje thuhet se "Partia jonë, pra, ka çuar shokë dhe u ka dhënë kompetencë të bisedojnë e të vendosin me Ballin. Shokët kanë rënë në kontakt si me të dërguarit e tyre, si individualisht. Të mos harrojmë se atje ka mjaft elementë të mirë e të vendosur, që duan me të vërtetë bashkim e luftë". Më pas: "Tani kontaktet zyrtare janë në vazhdim dhe brenda 15-20 ditëve duhet të marrin formë të prerë". Këtë letër me përbajtje direktive e ka firmosur me pseudonimin Taras vetë Enver Hoxha.

Në 23 shkurt 1943 ka vepruar një letër tjetër e Enver Hoxhës dërguar komitetit partiak vartës të Gjirokastrës. Që në fillim në të njoftohej: "Me Ballin Kombëtar u arrit ky përfundim: Partia jonë i parashtrori Ballit Kombëtar pikëpamjet e saj për luftën dhe organizimin e Luftës Nacionalçlirimtare dhe njëkohësisht i sqaroi Konferencën e Pezës dhe platformën politike të shprehur në rezolucionin e saj. Nga ana tjetër, i theksoi Ballit se duhej të bëhej një bashkim i vërtetë i të gjithë popullit...". Më poshtë: "... u përfundua kështu, që ne të kemi një lidhje me Ballin. Në çdo qytet do të ketë nga një komision për koordinim aksioni, i përbërë prej një shoku nga tanët dhe një prej atyre. Ky komision ka këtë të drejtë: njëra palë propozon të bëhet një aksion, kur duhet të bashkohet të dyja palët; në qoftë se aksioni pranohet, atëherë veprohet, në rastin e kundërt, pala që e propozoi aksionin e kryen vetë".

Nga mënyra se si është njoftuar komiteti qarkor i PKSH-së për Gjirokastrën dhe me këtë rast vetë partia në gjymtyrët e saj vartës, marrëveshja e mësipërme patjetër është kryer para 23 shkurtit 1943.

Ndërkohë në 17-19 mars u zhvillua në Labinot të Elbasanit Konferenca e Parë e Vendi e PKSH-së. Në këtë ngjarje Enver Hoxha më në fund u bë shef i partisë. Është Arkiva e Shtetit, që dëshmon se ditën e përfundimit të Konferencës së Parë të Vendi të Partisë Komuniste Shqiptare, më 19 mars 1943, mori formë të shkruar një tekst marrëveshjeje për krahinën e Kolonjës. Në të qenë rreshtuar njëmbëdhjetë pika bashkëpunimi dhe bashkëveprimi mes PKSH-së dhe Ballit Kombëtar: Fleta 42 e dosjes 22, viti 1943, e ruajtur në Arkivin e Shtetit, bën fjalë shprehimish për luftë të përbashkët të çetave nacionaliste dhe partizane për çlirimin e Atdheut nga zgjedha fashiste.

TERMI I ZHDUKUR UNÇPVSH

Tek letra udhëzuese e 23 shkurtit 1943 për komitetin qarkor të Gjirokastrës, Partia Komuniste saktëson: "Përsa u përket çetave, tani mund të shkojmë në taktikën e re dhe kurdoherë të shkruani: "Çeta partizane e vullnetare "X" ("Çerçiz Topullit", për shembull) e Ushtrisë Nacionalçlirimtare Shqiptare, e komanduar prej shokut X ose Y)".

Në letrën e nisur po këtë 23 shkurt, por në drejtim të Komitetit Qarkor të Korçës, thihet që vëmendja se "Sa herë që flitet o shkruhet për çeta, duhet të veprohet kështu: "Çeta partizane e vullnetare 'X' (emri i çetës, për shembull: "Themistokli

mëdha për organizimin e njëjësive më të mëdha të Ushtrisë Nacionalçlirimtare Partizane dhe Vullnetare Shqiptare (UNÇPVSH); tani s'na paraqiten vetëm aksione të vogla, por na paraqitet çështja e çlirimit të Shqipërisë".

Në 20 qershor 1943, në një qarkore tjetër për komitetet e PKSH nëpër qarqe, ku kërkohet që për të ngritur Brigadën e Parë duhet patjetër që në një vend të caktuar të dërgohen prej njëjësive të armatosura një numër luftëtarësh, thuhet shprehimisht "Brigada I e Ushtrisë Nacionalçlirimtare Partizane e Vullnetare". Në këtë udhëzues po ashtu nuk mungon edhe ky tekst: "Në Brigadën I dhe në batalionet e zonave



Germeji") e Ushtrisë Nacionalçlirimtare Shqiptare e komanduar prej shokut X ose patriotit Y" etj.).

Në referatën e mbajtur në mbledhjen e Komitetit Qendror të PKSH në një kasolle të Shmilit, në shkurt 1943, mes dymbëdhjetë parullave që jepen të rekomanduara për t'u përdorur; është edhe "Rroftë Ushtria Nacionalçlirimtare e Partizane Vullnetare e lirisë".

Gjurmë dokumentare të përdorimit të UNÇPVSH-së gjenden deri edhe shumë më herët, në nëntor 1942, në një artikull të "Zërit të Popullit" (numrat 8-9) të titulluar "28 Nëntori, dita e bashkimit të popullit shqiptar kundër zaptuesit fashist". Atje ndodhet edhe thirrja "Rrofshin çetat vullnetare e partizane!".

Por, është 10 prilli 1943, kur në një qarkore drejtuar tërë komiteeve të Partisë Komuniste të Shqipërisë nëpër qarqe, UNÇPVSH ka formulimin e saj të plotë. Teksti udhëzues përmban edhe këto fjalë: "Përpara nesh po hapen perspektiva të

të mbajtur një ushtri të përbashkët mes komunistëve dhe ballistëve.

Muaji gusht 1943, siç dihet, është i mbushur me shkëmbimin e letrave mospajtuese të Enver Hoxhës me Ymer Dishnicën si edhe informimin e qarkorëve në qytetet kryesore të vendit për gabimet e këtij të fundit gjatë realizimit të marrëveshjes së Mukjes. Por kjo që dredhi, pjesë e lojës për të justifikuar prishjen e dëshiruar prej kohësh të marrëveshjes prej PKSH-së, e cila me çdo rezultat dhe të dërguar politik nga komunistët të që, do të shkatërrohej. Dy protagonistët kryesorë BK dhe PKSH, qenë antagonistë deri në skaj, njëqind për qind të papajtueshëm.

Jo e rastësishme ishte ajo pamje që morën gjërat gjatë "pranverës". Nga muaji në muaj mundësia e dialogimit ra, prirja për ndeshje deri edhe me armë, u shtua. Kur mbërritën në Mukje, të dyja palët hall kishin kush do të përqendronte në duart e veta sa më tepër pushtet dhe në qeverisjen e pasluftës të që hegemon e fatpërcaktues për tjetrin. Kështu u nxorën armët, fillimisht nga komunistët e pastaj prej ballistëve.

GJOJA ÇËSHTJA E KOSOVËS

Mitat Qojle, një prej beratasve nga familje e njohur për emancipim politik, gjatë kohës së diktaturës me raporte mjaft miqësore me Ymer Dishnicën e izoluar në këtë qytet, ruan ende në kujtesë një hollësi. Ai thotë se doktor Dishnica i ka pohuar që gjatë bisedimeve në Mukje me delegacionin e Ballit Kombëtar, çështja e Kosovës u bë "thembra e Akilit". Megjithëse, kuptohet, për kohën as që mund ta kritikonte Enver Hoxhën, gjithsesi Ymer Dishnica i ka theksuar se jo vetëm ai, por edhe komunistët e tjerë në dërgatë si edhe vetë PKSH-në, "u qante zemra për Kosovën", pra për bashkimin e trojeve, por me ballistët që e shprehnin hapët këtë qëllim, njerëzit e Frontit Nacionalçlirimtare në delegacion, ku ndodhej edhe Abaz Kupi, bënë kujdes të mos ishte provokuese kjo çështje. Kështu, të dyja palët gjetën më në fund një formulë kompromisi.

Marrëveshja e Mukjes (për ngritjen e Komitetit të Shpëtitimit të Shqipërisë), u prish dhe mbi shpinën e saj u hodh si shkak kryesor çështja e Shqipërisë Etnike, por në thelb as kjo nuk që arsyeya kryesore. Të dyja palët bënë finte. Ata e donin të zgjidhur këtë çështje krejt njëjloj, përjashtoj thjesht formulën e të shkruarit në një dokument programatik. Ballistët e zmadhuan këtë çështje për të djallëzuar kombëtarisht komunistët shqiptarë që udhëzoheshin prej jugosllavëve Dushan e Miladin. Këta të fundit u fsheshën pas formulash të tjera dhe vërsulën mbi ballistët mëkatin kryesor të tyre: mosluftimin me armë të pushtuesve, sidomos nazigjermanëve.

PKSH dhe BK nuk kanë dashur asnjëherë të bashkëpunojnë singërisht, prandaj edhe Mukja që një hile e radhës. Ndaj edhe në këtë 75-vjetor, duke bërë me të drejtë një përkujtim për të, në të vërtetë ndërrojme një dëshirë, të thjeshtë. Ata që e kishin në dorë marrëveshjen e donin të funksiononte si një iluzion. Të mos ishte e tillë, lojë iluzioniste, nuk do të ndodhte të shpërbente në fund të dhjetorit 1943 tërë ai zemërim i gjeneralit britanik Dejvis.

Dje në 'Deutsche Welle'

G20-Argjentinë: Thirrje për ruajtjen e dialogut

(vijon nga faqja 1)

...dhe gjeopolitike paraqet rrezik për rritjen ekonomike globale. Ministrat e 20 vendeve të industrializuara dhe në ekspansion, në takimin e tyre në Argjentinë bënë thirrje për ruajtjen e dialogut për të tejkaluar grindjet tregtare. Ata pranuan në deklaratën e përbashkët pas takimit se rritja e tensioneve tregtare dhe gjeopolitike paraqet rrezik për rritjen ekonomike globale. Kjo deklaratë e takimit, ende një draft që mund të revizionohet nga vende të ndryshme vëren se ekonomitë e vendeve në zhvillim janë më tepër të përgatitura për të përballuar lëkundjet nga jashtë, por ato ende kanë sfida në përballimin e paqëndrueshmërisë të tregut dhe lëkundjeve të kapitalit. Në samitin e krerëve të 20 vendeve të industrializuara dhe në ekspansion që u zhvillua në Argjentinë, SHBA dha sinjale për bisedime me BE dhe Japoninë, madje edhe për një marrëveshje të tregtisë së lirë, SHBA do ishte gati - tha ministri i Financave, Steve Mnuchin. BE ka vënë si kusht për negociatën të reja tregtare heqjen e doganave për aluminin dhe çelikun para negociimit. "Nuk negociojmë me pistoletë në gjoks", ka thënë ministri francez i Financave, Bruno La Maire. BE shpreston në zgjidhjen e konfliktit tregtar me SHBA në tryezën e bisedimeve. "Nuk besoj se do të kemi një shkallëzim në të ardhmen për doganat", u shpreh Sekretari i Shtetit në Ministrinë austriake të Financave, Hubertus Fuchs, të dielën pas takimit të G20-s.

Në samit do të duhej të ishte në fokus e ardhmja e punës dhe përmirësimi i infrastrukturës. Por këto kaluan në hije, për shkak të grindjes së vazhdueshme së SHBA me Kinën dhe BE për doganat ndëshkuese.

Ministri gjerman i Financave, Olaf Scholz kërkoi në kryeqytetin argjentinas ruajtjen e tregtisë së lirë në kuadër të grindjes me



SHBA. "Përfitimet në mirëqenie janë më të mëdha, kur ne koopoerojmë", tha politikani socialdemokrat në takimin e ministrave të Financave në Argjentinë. Scholz nuk e pranoi kritikën e amerikanëve për politikën tregtare të europianëve. "BE zhvillon një politikë të arsyeshme. Ne nuk

përpiqemi përmes barazimit së valutës të krijojmë avantazhe ekonomike".

KRYETARJA E FMN-SË PARALAJMËRON NGA RËNIA EKONOMIKE

Kryetarja e Fondit Monetar Ndërkombëtar, FMN, Christine Lagarde paralajmëroi shtetet e

G20-s nga shkallëzimi i konfliktit tregtar. "Në rastin më të keq ekonomike botërore me 05,%" , tha ajo. Për këtë, ajo do t'u paraqesë ministrave një raport të posaçëm. Rritja më e pakët ekonomike, sipas vlerësimit të FMN-së kërcënon të bëhet re-

alitet, nëse zbatohen të gjitha doganat ndëshkuese amerikane dhe masat reciproke të vendeve përkatëse. Që në fillim të takimit, Lagarde u shpreh se luftërat tregtare i shkaktojnë miliarda ekonomive popullore. Edhe presidenti i Bankës Kombëtare Zvicerane, Thomas Jordan, i ftuar në samitin e G20-s u shpreh me shqetësim se "grindja tregtare mund të shkallëzohet më tej".

SHBA ME KUSHTE

Ministri amerikan i Financave, Steven Mnuchin përforcoi edhe njëherë kërkesën e tij për shanse të drejta për vendin e tij në tregtinë me Kinën dhe SHBA. Qeveria në Uashington e ka "dëshirën për një marrëdhënie të balancuar", e për këtë është e nevojshme të importohen më shumë produkte amerikane. Kina duhet të hape tregjet për SHBA "me qëllim që ne të konkurrojmë drejt dhe të rrisim eksportet tonë", kërkoi Mnuchin. Nëse Kina nuk lëviz nga pozicionet e saj, atëherë kërcënimet e presidentit Trump për të vendosur dogana ndëshkuese ndaj të gjitha produkteve kineze "është një mundësi realiste", paralajmëroi Mnuchin.

Edhe në drejtim të Europës, ministri amerikan kishte mesazhe të qarta. "Nëse Europa beson në tregtinë e lirë, atëherë ne jemi të gatshëm të nënshkruajmë një marrëveshje tregtare pa dogana, pa kufizime dhe pa subvencione", tha ai. Por në këtë rast duhet të përbushen të tria kriteret". Por ministri francez i Financave, Bruno Le Maire u shpreh se pa heqjen e doganave ndëshkuese për çelikun dhe aluminin, nuk do të ketë negociatën për një marrëveshje tregtare. Në këtë pikë Gjermania dhe Franca janë të një mendimi. "Ne presim që SHBA të ndërmarrë hapat e nevojshme, për të dalë nga kjo luftë tregtare", tha Le Maire. Ai i bëri thirrje SHBA-ve t'u kthehen arsyes e të respektojnë partnerët. Vendet e G20-s përfaqësojnë 85% të kapacitetit ekonomik botëror, dy të tretat e popullsisë botërore dhe lëvrojnë 75% të tregtisë globale.



BLUE TOOTH

THASHETHEME MADE IN ALBANIA



te rejat nga jeta ipave

çdo të shtunë falas me

Opinioni *i* Ditës

Duhet ulur çmimi i energjisë elektrike?

Nga Fatos Çoçoli

(vijon nga faqja 1)

...Vendimi ishte i drejtë, pse humbjet në rrjet ishin të mëdha, sistemi energjetik gati në kolaps dhe viti hidrik 2013 tejet i keq. Ndërkohë, këto tri vitet e fundit pa lëvizje çmimi të energjisë elektrike (2016-2018) tek ne, përbëjnë një gjendje të pazakontë. Zakonisht, në të gjitha vendet evropiane dhe në botën mbarë, energjia ngrihet apo ulet, nganjëherë edhe brenda vitit, ngaqë është një treg shumë dinamik. Për shembull, në Itali për vitin 2017, është ulur me 12 për qind. Është ulur, por më pak edhe në disa vende të rajonit tonë si në Serbi, Maqedoni, Mal të Zi, etj. Tek ne çmimi i energjisë elektrike ka qëndruar pa lëvizur, edhe pse vetë Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHE) përmend me mburrje se për periudhën 2014-2017 ka ulur humbjet joteknike në rrjet me mbi 30 për qind! Shumë mirë ka bërë, por pse nuk ul çmimin?! Ndërkohë që humbjet joteknike përbëjnë një nga zërat më të rëndësishëm të kostos së rritur të energjisë elektrike tek ne. Jemi më të shtrenjtët në rajon! Shqipëria rezultoi një nga vendet me çmimin më të lartë të energjisë elektrike në rajonin e Ballkanit në kuotën 9 cent të euros për kWh (kilovat/orë), përfshirë taksat. Çmimi në Shqipëri është ndjeshëm më i lartë se sa në Maqedoni (8 cent), Serbi (7 cent) apo Kosovë (po 7 cent). Nuk duhet të harrojmë se tregu i shitjes së energjisë elektrike është një nga më të rëndësishmit në vendin tonë. Për 550 mijë familjet shqiptare që e blejnë energjinë nga OSHEE janë rreth 30 milionë euro që arkëtohen mesatarisht në muaj, kjo ndërmarrje tërësisht shtetërore, ose 360 milionë euro në vit. Madje, për familjet e varfra shqiptare (janë mbi



130 mijë të tilla), shpenzimi i energjisë elektrike (ajo faturë e shkretë objekt shumë kokëçarjesh e hallesh të mëdha, kur nuk ke ta paguash) shkon edhe në një të katërtën apo edhe të tretën e parave të pakta që fitojnë, sidomos për periudhën e dimrit. Megjithatë gjend-

je shumë të keqe shoqërore ku familjet e varfra janë tek ne, me perspektiva të pakta punësimi, edhe pse kushtet ishin të ulët çmimi në dhjetor 2016 dhe dhjetor 2017, kjo nuk u bë. Po pse ishin kushtet? Sepse, përveç uljes së fortë të humbjeve joteknike në rrjet (vetëm këto duhet

ta kishin ulur çmimin me të paktën 4 për qind për familjarët), për shkak të viteve të mira hidrike 2016 dhe 2017, OSHEE ka dalë me fitim akoma më të madh se ai i autorizuar nga Enti Rregullator i Energjisë (ERE). Dhe sipas ligjit, ku mbështetet ERE në punën e saj, të ardhurat e paa-

torizuara të fituara, sipas metodologjisë së tarifave të shndërruara në ligj, duhet të kompensoheshin te konsumatorët përmes uljes së çmimit për periudhën pasardhëse. Dhe e dini sa janë këto të ardhura të paautorizuara (fitim shtesë) realizuar nga OSHEE për vitet 2015-2017? Janë 14 miliardë lekë të reja, ose 117 milionë euro! Mund ta kishin ulur çmimin për familjet tona edhe me 13-14 për qind në dhjetor 2016 dhe në dhjetor 2017. Ndoshta drejtuesve të këtyre enteve shtetërore 5 mijë lekë të vjetra paguar më pak për faturën e dritës nga një familje e varfër çdo muaj u duken pak. Por sinqerisht, nuk janë pak zotërinj. Dhe ligji të 500 mijë varfanjakëve shqiptarë ua jep, kurse ju nuk ua keni dhënë! Proveni të mos ua jepni në dhjetor 2018! Nëse ERE nuk lëviz, nëse kryeministri nuk lëviz, do të mobilizohet opinioni i shëndoshë publik i vendit, për t'ju vënë përpara përgjegjësisë. Ndoshta edhe opozita mund ta ketë një 'kalë' të mirë beteje, mungesën e ndershmërisë dhe transparencës me detyrimet ligjore për t'ua ulur çmimin e energjisë elektrike shqiptarëve, tani që 'kuajt' kicë të kriminalizimit dhe kanabizimit të qeverisjes i janë lodhur rrugës. Duke hequr këtë një muaj e diçka korrik-gusht që po shkon me pushime, janë katër muaj deri në fund të dhjetorit 2018 për opozitën, që të kërkojë me forcë që ERE të vendosë uljen e çmimit të energjisë elektrike për familjarët. Janë të gjitha të dhënat, pasqyrat financiare, të analizuara me mjeshtëri nga një hulumtim gazetaresk i BIRN. Janë 500 mijë të varfër të këtij vendi që presin një lehtësim sado të vogël të gjendjes së tyre, lehtësim që ligji jua siguron, por 'Maliqi' nuk jua jep...

BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.
LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.



Opinion i Ditës

IN MEMORIAM

Jacek Psheniosllo, mik i vërtetë dhe i singertë i popullit shqiptar


(vijon nga faqja 1)

Pak ditë më parë u nda nga jeta në Varshavë, në moshën 78-vjeçare, kolegu dhe bashkëpunëtori i ynë i ngushtë, Jacek Przeniosllo (Jacek Przenios'o), mik i vërtetë dhe i singertë i Shqipërisë dhe popullit shqiptar.

Lidhjet e tij me Shqipërinë janë të hershme, që në moshën e rinisë së tij. Ai erdhi në Shqipëri me familjen e tij, sepse i ati, Stefan Przenios'o, në vitet 1956-1961 kreu misionin e lartë të Ambasadorit të Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë të Polonisë në vendin tonë. Jacek-u përfundoi në Tiranë shkollën mesme dhe kreu disa vite studimi në Universitetin e Tiranës, ku mësoi dhe gjuhën shqipe. Gjatë qëndrimit dhe studimeve në Shqipëri, në qarqet studentore shqiptare Jacek-u u bë një figurë e dashur dhe popullore. Edhe sot e kësaj dite, shumë prej studentëve shqiptarë të brezit të tij kujtojnë Zhak-un, siç e thërrisnin atëherë nga që kish lindur në Paris para fillimit të Luftës II Botërore, sepse prindërit e tij kishin emigruar prej vitesh në Francë, si një student shumë energjik, të dashur dhe iniciator i shumë veprimtarive shoqërore kulturore dhe sportive. Ai merrte pjesë aktive në mbledhjet që organizoheshin me studentët, në ekskursionet në natyrë, madje deri në organizimin e shëtitjeve me biçikleta edhe në linjën Tiranë-Durrës e kthim.

Mbas kthimit në atdhe, që ndodhi edhe me prishjen e marrëdhënieve për shkaqe ideologjike të vendit tonë me ish-vendet socialiste të bllokut Lindor, përfshi këtu edhe Poloninë, Jacek-u punoi në institucione të ndryshme shtetërore dhe shkencore të Polonisë, ndërmjet të tjerave edhe në Akademinë e Shkencave. Për shkak të njohurive të shumta që kish për Shqipërinë dhe njohjes së gjuhës shqipe, Jacek-u për këto institucione u bë pikë referimi lidhur me marrëdhëniet e Polonisë me Shqipërinë, duke u bërë shpesh pjesëmarrës i delegacioneve polake që zhvillonin bisedime me delegacionet tona.

Mbas përmbyesjes së regjimeve komuniste në Poloni dhe në Shqipëri, (kujtojmë që Polonia ishte vendi i parë që e përmbyu këtë regjim ndër ish-vendet socialiste të Europës Lindore), midis dy vendeve tona u normalizuan marrëdhëniet në të gjitha fushat, përfshi edhe marrëdhëniet ndërreze midis popujve të tyre. Jacek-u ishte një nga iniciatorët kryesorë të themelimit të Shoqatës Poloni-Shqipëri në Varshavë dhe që në fillim të veprimtarisë, ai u zgjodh nënkryetar i saj. Gjatë veprimtarisë së kësaj shoqate, Jacek-u kreu edhe detyrat e kryetarit dhe vitet e fundit atë të Kryetarit të Nderit të saj. Jacek-u zhvilloi një veprimtari të gjerë për propagandimin e vendit



tonë në Poloni. Ai është autor i shumë shkrimeve në shtypin polak dhe në mediat polake, kushtuar historisë së popullit shqiptar, traditave të tij kulturore dhe vlerave turistike të vendit tonë. Në kuadër të Shoqatës Poloni-Shqipëri ka qenë një nga organizatorët kryesorë të veprimtarive të shumta që kjo shoqatë ka organizuar në Poloni kushtuar vendit tonë. Me plot kuptimin e fjalës, Jacek-u ka qenë një ambasador i vendit tonë në Poloni.

Jacek-u kontriboi edhe në zhvillimin e marrëdhënieve ekonomike midis dy vendeve tona. Ai ka qenë iniciatori i disa investimeve të firmave polake në Shqipëri si edhe i vendosjes së lidhjeve të firmave polake me ato shqiptare për zhvillimin e shkëmbimeve tregtare mi-

dis tyre. Dashurinë që kishte për Shqipërinë dhe popullin shqiptar, Jacek-u ia transmetoi të gjithë familjes së tij. E shoqja e tij, Aleksandra, vajza Marta dhe djali, Stefan-i kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë miq të ngushtë të popullit shqiptar. Vajza e tij, Marta për disa vite studio në Universitetin e Tiranës gjuhën shqipe dhe sot është diplomate e zonja, që përfaqëson me dinjitet Poloninë në përfaqësitë e saj diplomatike jashtë shtetit dhe në organizatat ndërkombëtare. Ndonëse në moshë dhe gjendje shëndetësore jo të mirë, Jacek-u me bashkëshorten vinin pothuajse çdo vit në Shqipëri për të pushuar dhe për t'u takuar me miqtë dhe shokët e tij shqiptarë. Për meritat e tij të shquara në pro-

pagandimin e vendit tonë në Poloni dhe kontributin për forcimin e marrëdhënieve midis dy vendeve tona, Jacek Psheniosllo, në vitin 2004 është dekoruar nga Presidenti i Republikës, Alfred Moisiu, me medaljen e lartë "Naim Frashëri". Me ndarjen e tij nga jeta, Shqipëria humbi një mik të vërtetë dhe të singertë, që gjithë jetën ia përkushtoi forcimit të lidhjeve miqësore midis dy vendeve tona, ndërsa ne që e njohëm nga afër dhe kemi bashkëpunuar me të, humbëm një mik dhe shok të dashur, i cili do të mbetet i paharuar në mendjet dhe zemrat tona. Osman Kraja, Leonard Zissi, Ermal Dobi, Naim Tyli, Pandelli Çina, Arqile Teta, Astrit Beqiraj, Petrit Dollani, Ylli Alibali, Neki Shehu.

HOROSKOPI

DASHI

Ngazëllohuni sa më shumë dhe do të keni energji shtesë. Edhe pse paratë do ju dalin nga duart lehtësisht, yjet do ju sjellin sërish para në llogarinë tuaj. Mos kini frikë të thoni atë që mendoni.

DEMI

Shanset për t'u shëruar nga sëmundjet janë të larta sot për shenjen tuaj. Vështrësitë finie e të ardhurave nga investimet e kapërcëhen, pasi prindërit tuaj ju japin shumë mbështetje. Një ditë e favorshme për çështjet ligjore.

BINJAKET

Shmangni çdo investim afatgjatë dhe përpuni të dilni jashtë dhe të kaloni momente të këndshme me mikun tuaj më të mirë. Një mik mund të kërkoi këshillën tuaj për të zgjidhur problemet e tij personale. Udhëtimet do të ishin të dobishme, por pa shpenzuar shumë.

GAFORJA

Bëni shumë kujdes me shëndetin tuaj, sidomos për personat me probleme tensioni. Pozicioni i parave do të përmirësohet më vonë gjatë ditës. Sot njerëzit do t'ju bëjnë komplimente, të cilat ju keni dashur gjithmonë t'i dëgjoni. Një shëtitje buzë detit do ju bënte mirë.

LUANI

Mos merrni vendime të nxitura, veçanërisht kur bisedoni për marrëveshjet kryesore financiare. Marrëdhënia juaj dashurore mund të mos jetë në formën më të mirë për shkak të mungesës së kohës. Mos e merrni dashurinë si të mirëqenë, por investoni më shumë kohë ndaj partnerit.

VIrgJERESHA

Shëndeti juaj ka nevojë për kujdes. Është parashikuar rritje e të ardhurave nga investimet e kaluara. Situata juaj romantike mund të jetë në gjendje të vështirë sot. Kontrolloni sjelljen e nxituar, pasi ajo mund të shkatërrojë një miqësi të mirë. Edhe lidhja juaj emocionale me bashkëshortin tënd mund të mos jetë në formën e duhur.

PESHORJA

Gjatë kësaj dite do të jeni në gjendje të relaksoheni. Një projekt i rëndësishëm do të ndalet për shkak të pozicionit të zymtë financiar. Ditë e shkëlqyer për marrëdhëniet me miqtë. Sot, do të riktheheni në adollescencën tuaj.

AKREPI

Aktivitetet me miqtë do të jenë të këndshme, por përpuni të bëni kujdes me paratë. Lidhja romantike mund të jetë pak e vështirë. Çështjet e taksave dhe sigurimeve do të duhet të kenë një vëmendje më të madhe.

SHIGJETARI

Çështjet e brendshme mund t'ju shkaktojnë shqetësim. Investimet janë të rekomanduara, por kërkoni këshilla të përstatshme. Bashkëshortja do të ndihmonte në ndryshimin e jetës suaj. Niveli dhe energjisë do të jenë të larta sot.

BRICJAPI

Mundohuni të mbani nën kontroll emocionet. Mos e humbi kohën në gjetjen e fajt nëse lidhja juaj nuk po funksionon. Nuk është diçka e keqe të ndërrosh për sukses, por kallimi i kohës së çmuar vetëm nuk është një ide e mirë.


UJORI

Ditë e mirë e mbushur me lumtur. Investimet e zgjuara do të bëjnë që të merrni shumë fitime. Një ditë e mirë për të ringjallur kontaktet dhe marrëdhëniet e vjetra. Po nuk treguat kujdes, mund të humbësh dashurinë e vërtetë në jetën tënde.

PESHQIT

Mos e humbi qetësinë në asnjë mënyrë, sepse ajo do të shkaktojë disa krisje të përshkrahme në familje. Një shtëpi e ndarë nuk mund të qëndrojë. Problemet financiare do të lehtësohen me ndihmën e miqve tuaj. Ju do të zgjeroni bazën e miqve dhe të njohurive.

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

- Me të nxjerrin një tapë.
- Inicialet e Klee piktor.
- Qiriaçi aktor.
- Etikë pa kufij.
- Merren për shembull.
- Fund janari.
- Janë edhe ata të skuadrës.
- Ortoli kompozitor.
- Ushtrrohej edhe nga bukanierët.
- Në krye të sondazheve.
- Janë të ndaluara në kthesë.
- Ente Rajonale Civile.
- Gjermania në tabela.
- Mund të jetë unik.
- Philippe që qe aktor.
- Një pjesë e pelegrinazhit.
- Gjysmë leader.
- Maten pa zë.
- Janë të përpjeta.
- Qytet anglez.

- Louis, poet surrealist.
- Artet pa re.
- Matet pa kufij.
- Gruaja e Ben Hur.
- Liam i Schindler's list.
- Të parat në orkestër.
- Makina Ibiza.
- Renato, piktor i famshëm italian.
- Mihali këngëtare lirike.
- Janë aftësi prodhuese të fabrikës.
- Një gjuajtës francez.
- Eshtë porti i Durrësit.
- Kërkojnë origjinën e fjalës të tillë.
- Pak pirografi.
- Një pjesë e aerobisë.
- U vodhi zarrin perëndive.
- Premtojnë të bëhen asa.
- Mbeten në fund.
- Rreth pa ekstreme.
- Rendi pa zë.
- Eshtë veshje tahtianësh.
- Tase e volebollit.
- Eshtë shahu i fundit.
- Kim... Stuart aktor.
- Fritz regjisor.
- Ai i shtatë është kinemaja.
- Një pjesë e ansamblit.
- Difong teatral.
- Të parat në stacion.
- Oendër në tour.
- Mbarojnë fare.

VERTIKAL

- Mbyllin fushata.
- Një pjesë e pikturave.
- Janë njëvjeçarë.
- Një ngjyhet në tavolocë.
- Eshtë katolik ai i papës.
- Mbyllin portat.
- Opera e Mascagni-t.
- Tregohet duke bërë masakra.
- Janë aftësi prodhuese të fabrikës.
- Një gjuajtës francez.
- Eshtë porti i Durrësit.
- Kërkojnë origjinën e fjalës të tillë.
- Pak pirografi.
- Një pjesë e aerobisë.
- U vodhi zarrin perëndive.
- Premtojnë të bëhen asa.
- Mbeten në fund.
- Rreth pa ekstreme.
- Rendi pa zë.
- Eshtë veshje tahtianësh.
- Tase e volebollit.
- Eshtë shahu i fundit.
- Kim... Stuart aktor.
- Fritz regjisor.
- Ai i shtatë është kinemaja.
- Një pjesë e ansamblit.
- Difong teatral.
- Të parat në stacion.
- Oendër në tour.
- Mbarojnë fare.


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


- Harris aktor.
- Termocentrali i shkurtër.
- Organizata me koska.
- Një tufë bagëtish.
- Inicialet e Redford.
- Kështu thonë se bëhet ai që mërëzitet.
- Scarlet e Bashkë e erën.
- Elvira aktore.
- Eshtë Panorama që ke në dorë.
- Ushtojnë nga "ola".
- Shtet aziatik.
- Eshtë ministri.
- Në radhtë të parë.
- G... për njerëzit e FBI.
- Makina Micra.
- Mund të jetë proteste.
- Pasur pa kufij.
- Gjika e Dora d'Istria.
- Të fundit në dhjetor.

VERTIKAL


- Umberto që shkroi Baudolino.
- Bertë këngëtare italiane.
- Fillojnë një temë.
- Një garë në hipodrom.
- Qe burri i parë.
- Një ndriçues.
- Bëjnë shirit me shi.
- Dha fillin Tezetur.
- Vihen për të mbyllur.
- Para Saint-Germain në futboll.
- Qëllon në një vend.
- Eshtë dosja e të pandehurit.
- Janë përmasat.
- Mbush në kufij.
- I bëjnë duart me ar.
- Inicialet e dali piktor.
- Fillojnë argumentin.
- Makina Ibiza.
- Emri i Einstein.
- Ndriçojnë rrugët.
- Kim që qe aktore.
- I hedh i dorzuar.
- Inicialet e Nolte aktor.
- Ishin rapsodët e akeje.
- Fund shkurti.
- Van der portier holandez.
- Fillojnë masat.
- Inicialet e Rohmer.
- Fillojnë teorikisht.
- Numër i shkurtër.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

				1	
3		8	2		4
		6			9
	1	7		2	3
		2			
5			8	9	
	9			1	4
6		5	9		
				7	5

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

8	5	6	4	2	7	3	9	1
7	4	1	5	9	3	2	8	6
3	9	2	6	8	1	4	7	5
1	3	7	2	4	8	5	6	9
9	6	4	3	1	5	7	2	8
5	2	8	7	6	9	1	4	3
4	7	5	9	3	6	8	1	2
6	1	3	8	7	2	9	5	4
2	8	9	1	5	4	6	3	7

Argëtim filozofik

- Eshtë normale, të gjithë bëhen filozofë kur nuk është problemi i tyre.
- Mos prisni askënd në jetën tuaj ... shkoni përpara ... dhe ata që duan, do t'ju arrijnë !!!
- ...Dhe vjen një ditë kur ti e kupton se "çdo gjë" ishte "asgjë" vetëm një zhgënjim !!!
- Çdo herë që përpiqem të ndryshoj ... përfundoj të jem vetvetja!!!

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME
Përgjigja e numrit të djeshëm

3	P	U	6	S	I	15	2	3	5	7	3
2	4	8		4	7		8	6		9	1
6	1		3	10	9	10	4	1	11	8	5
12		3	8	11	7	4	8	13	8		5
5	4	1	3	8	11	7	16	7	13	8	
10		3	8	5	8	5	1	11	8	5	
5	3	10	6	8		1	5		5	7	18
1	8	4			3	4	8	11	1	13	10
4	1	17	12	8	10	4		6	1	9	
6	5	1	9	10	5		10		2	15	10
4	2	16			8			2	15	10	
4	1	17	12	8	4	18			5	8	

A	R	T	M	K	R	I	M	B	A	T
N	G	U	J	I	M	U	A	N	E	
I	B	A	N	I	M	K	H	M	E	R
J	H	K	A	N	I	B	A	L	E	T
E	B	O	T	E	R	O	R	E	T	
L	A	B	O	R	A	T	O	R	E	T
H	A	I	R	V	A	N	O	R		
R	E	N	E	A	N	T	R	E	H	
A	V	E	T	V	I	I	I	G	U	
K	A	N	T	M	E	K		T	I	N
U	T	I	B	E	T	A	T	E	M	E
J	R	R	U	G	A	A	R	T	E	T

PËRGJIGJET E FJALËKRYQJEVE TË NUMRIT TË KALUAR

A	L	E	N	S	G	P	O	A	Z	I
M	I	S	H	N	D	O	R	E	S	H
A	R	A	M	O	G	O	A	U	I	T
M	K	I	M	N	O	V	A	K	O	N
T	S	E	R	A	T	I	A	R	I	T
F	R	E	T	E	N	D	I	M	I	O
R	O	N	A	L	D	O	I	G	A	E
M	A	L	E	N	G	O	R	E	T	
B	A	T	A	R	I	A	T	E	R	O
I	R	O	N	A	C	E	M	Y		
T	I	R	I	K	E	P	A	R	O	D
T	O	I	R	A	C	O	R	O	T	K
F	A	L	L	I	K	F	S	D	O	R
A	D	A	M	P	A	L	I	M	I	N
L	E	M	T	A	B	E	L	A	T	
M	T	M	A	P	T	U	L	L	M	I
N	M	A	R	I	N	A	R	I	I	L
G	R	E	M	I	N	A	U	E	F	E
A	R	I	F	D	E	N	T	I	S	T
P	I	K	A	T	E	S	E	R	T	E
C	I	T	A	T	E	M	E	T	E	O
O	S	Z	R	A	M	L	E	R	T	
S	H	T	E	P	I	T	E	L	J	A
A	E	K	A	M	I	V	I	S	A	R



Thënie të mençura

- Kush kontrollon të shkuarën kontrollon të ardhmen. Kushdo që kontrollon të tashmen kontrollon të shkuarën.
- Shumë herë ne jemi të mirë, sepse nuk mund të jemi të këqij.
- Në fund, nuk do të kujtojmë fjalët e armiqve tanë, por heshtjen e miqve tanë.
- Veshët besojnë më vështirë se sytë.
- Tragjedia në jetë është se po bëhemi pleq shumë shpejt dhe të mençur shumë vonë.
- Budallai që ecën, është me më shumë vlerë se dhjetë intelektualë që rrinë.

